



# REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR



ANALIZA VJETORE E PUNËS

2023



SHKURT 2024

RRUGA "JORDAN MISJA" NR.1, 1057 TIRANË

tel/fax 0035542231527; [www.gjp.gov.al](http://www.gjp.gov.al)

**ANALIZA VJETORE E PUNËS**

**PËR VITIN 2023**

**E**

**GJYKATËS SË POSAÇME TË SHKALLËS SË PARË**

**PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR**

**TIRANË 2024**

## **TABLELA E LËNDËS**

I. PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I GJYKATËS .....	3
II. ADMINISTRIMI I GJYKATËS .....	9
III. EFIKASITETI I PUNËS PERGJATË VITIT 2023, KRAHASIMI ME VITET 2022 DHE 2021.....	16
IV. VEPRIMTARIA E GJYKATËS, AFATET KOHORE PROCEDURIALE DHE VLERËSIMI.....	28
V. KRYESEKRETARIA.....	50
VI. DREJTORIA E BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR .....	53
VII. SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE, SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE DHE PROKURIMEVE .....	60
VIII. SEKTORI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT, STATISTIKAVE, MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN, MEDIAN DHE ME JASHTË.....	65
IX. ANALIZA E PUNËS SË SEKTORIT TË PROTOKOLL/ARKIVËS .....	80
X. OBJEKTIVA DHE REKOMANDIME.....	84

## I. PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I GJYKATËS

Reforma në Drejtësi është një nga zhvillimet më të rëndësishme ligjore, që ka ndodhur në vendin tonë në 30 vitet e fundit, e cila ka në fokus krijimin e një sistemi ligjor koherent, eficient, të konsoliduar dhe të harmonizuar me standardet ndërkombëtare, sistem që i përgjigjet nevojave dhe shkallës së zhvillimit të vendit, me ndikim të drejtpërdrejtë në forcimin dhe konsolidimin e shtetit të së drejtës, e njëherazi garantimin e funksionimit të parimeve kryesore të tij si: parimi i sigurisë juridike dhe parimi i pavarësisë së sistemit të drejtësisë. Me pritshmëri të larta publike, reforma në drejtësi, si proces i jashtëzakonshëm, gjithëpërfshirës, në të cilin u kombinua ekspertiza më e mirë vendase dhe e huaj me standardet më të larta ndërkombëtare të fushës, me mbështetje të qartë nga partnerët strategjikë SHBA e BE, si dhe konsensusin absolut politik, u materializua me një votim unanim në Kuvend në korrik të vitit 2016.

Një prej institucioneve të reja të krijuara në kuadër të zbatimit të reformës rrënjësore në fushën e drejtësisë ishte edhe Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar<sup>1</sup>, e cila në vitin 2023 hyri në vitin e katërt të funksionimit të saj.

Për përballimin e sfidave të reja gjatë aktivitetit të GJKKO-së, u hapën dhe horizonte të reja, përkatësisht ngritja e mekanizmave të komunikimit efikas virtual në mënyrë që të mbahet ritmi i institucionit, në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së rregullt gjyqësore. Përgjatë këtij viti, GJKKO ka ushtruar veprimtarinë me një trupë gjyqësore të përbërë vetëm nga nëntë gjyqtarë, nga 16 gjyqtarë të planifikuar si pjesë e organikës së kësaj gjykate, duke përmbushur dhe realizuar të gjitha sfidat, në funksion të dhënies së drejtësisë.

Pavarësia e sistemit të drejtësisë, si një element i rëndësishëm i shtetit të së drejtës është e domosdoshme për të garantuar mirëfunksionimin e sistemit të drejtësisë, rritjen e përgjegjshmërisë së magjistratëve, paanësinë e tyre në vendimmarrje. Nga ana tjetër, pavarësia nuk duhet parë si një qëllim në vetvete, e për këtë arsye, ajo duhet të shoqërohet me mjete dhe mekanizmat përkatës të përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies, për të siguruar që sistemi gjyqësor dhe ai i prokurorisë, të veprojnë në përputhje me parimet dhe interesat legjitime të një shoqërie demokratike.

GJKKO zhvillon veprimtarinë e saj, sipas ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”. Ajo filloi funksionimin më datë 19 dhjetor 2019, në bazë të Vendimit Nr. 286, datë 18.12.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për fillimin e funksionimit të Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”,

---

<sup>1</sup> Në vijim me shkurtime GJKKO.

duke planifikuar në organikën e gjykatës, trupë gjyqësore të përbërë prej 16 (gjashtëmbëdhjetë) gjyqtarësh.

GJKKO ka në kompetencën e saj tokësore të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe si qendër të ushtrimit të veprimtarisë së saj qytetin e Tiranës. Kompetenca lëndore e GJKKO-së përcaktohet nga neni 75/a i K.Pr.Penale, e cila nuk mund të tejkalojë kompetencën e përcaktuar nga neni 135/2 i Kushtetutës<sup>2</sup> dhe kryesisht fokusohet në veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, si dhe akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Kryetarit të Bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj, si dhe akuzat kundër ish-funksionarëve të sipërpërmendur.

Kompetencat e GJKKO-së përfshijnë veprat penale të parashikuara në dispozitat e mëposhtme:

1. **Neni 230 i Kodit Penal:** Vepra me qëllime terroriste;
2. **Neni 230/a i Kodit Penal:** Financimi i terrorizmit;
3. **Neni 230/b i Kodit Penal:** Fshehja e fondeve dhe e pasurive të tjera, që financojnë terrorizmin;
4. **Neni 230/c i Kodit Penal:** Dhënia e informacioneve nga persona që ushtrojnë funksione publike ose në ushtrim të detyrës a profesionit;
5. **Neni 230/ç i Kodit Penal:** Kryerja e shërbimeve dhe veprimeve me persona të shpallur;
6. **Neni 231 i Kodit Penal:** Rekrutimi i personave për kryerjen e veprave me qëllime terroriste ose të financimit të terrorizmit;
7. **Neni 232 i Kodit Penal:** Stërvitja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste;
8. **Neni 232/a i Kodit Penal:** Nxitja, thirrja publike dhe propaganda për kryerjen e veprave me qëllime terroriste;
9. **Neni 232/b i Kodit Penal:** Kanosja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste;
10. **Neni 233 i Kodit Penal:** Krijimi i turmave të armatosura;
11. **Neni 234 i Kodit Penal:** Prodhimi i armëve luftarake;
12. **Neni 234/a i Kodit Penal:** Organizata terroriste;
13. **Neni 234/b i Kodit Penal:** Banda e armatosur;
14. **Neni 244 (paragrafi 2) i Kodit Penal:** Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike;

---

<sup>2</sup> Neni 135 "...2. Gjykatat e posaçme gjykojnë veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, si dhe akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë 37 të Drejtësisë, Kryetarit të Bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj, si dhe akuzat kundër ish-funksionarëve të sipërpërmendur..."

15. **Neni 244/a i Kodit Penal:** Korrupsioni aktiv i nëpunësve të huaj publikë;
16. **Neni 245 i Kodit Penal:** Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë;
17. **Neni 245/1 (paragrafët 3 & 4) i Kodit Penal:** Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike;
18. **Neni 257 i Kodit Penal:** Përfitim i paligjshëm i interesave;
19. **Neni 258 (paragrafi 2) i Kodit Penal:** Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike;
20. **Neni 259 (paragrafi 2) i Kodit Penal:** Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike;
21. **Neni 259/a i Kodit Penal:** Korrupsioni pasiv i nëpunësve të huaj publikë;
22. **Neni 260 i Kodit Penal:** Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë;
23. **Neni 312 i Kodit Penal:** Korrupsioni aktiv i dëshmitarit, i ekspertit ose përkthyesit;
24. **Neni 319 i Kodit Penal:** Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë;
25. **Neni 319/a i Kodit Penal:** Korrupsioni aktiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare;
26. **Neni 319/b i Kodit Penal:** Korrupsioni aktiv i arbitrit vendas dhe të huaj;
27. **Neni 319/c i Kodit Penal:** Korrupsioni aktiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja;
28. **Neni 319/ç i Kodit Penal:** Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë;
29. **Neni 319/d i Kodit Penal:** Korrupsioni pasiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare;
30. **Neni 319/dh i Kodit Penal:** Korrupsioni pasiv i arbitrit vendas dhe të huaj;
31. **Neni 319/e i Kodit Penal:** Korrupsioni pasiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja;
32. **Neni 328 i Kodit Penal:** Korrupsioni aktiv në zgjedhje;
33. **Neni 328/b i Kodit Penal:** Korrupsioni pasiv në zgjedhje;

*Veprat penale të kryera në kuadër të organizatave kriminale:*

34. **Neni 28 i Kodit Penal:** Forma të veçanta të bashkëpunimit;
35. **Neni 333 i Kodit Penal:** Organizata Kriminale;
36. **Neni 333/a i Kodit Penal:** Grup i strukturuar kriminal;
37. **Neni 334 i Kodit Penal:** Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grup i strukturuar kriminal.

*Përveç sa më sipër, GJKKO gjykon edhe veprat penale si vijojnë:*

38. Akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së

Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kryetarit të bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj;

**39.** Akuzat penale kundër ish-funksionarëve të mësipërm, kur vepra është kryer gjatë ushtrimit të detyrës.

**40. Neni 119, 120 i Kodit Penal** dhe të gjitha veprat e tjera penale që iniciohen me kërkesën e viktimës akuzuese.

▪ **Subjektet e Posaçme edhe për veprat penale që nuk janë në kompetencën e GJKKO-së.**

1. Gjykata e Lartë, me vendimin Nr. 00-2021-712 (23), datë 27.07.2021, ka njehsuar praktikën gjyqësore duke unifikuar se Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar është kompetente për shqyrtimin e të gjitha akuzave penale të ngritura ndaj një subjekti të posaçëm të parashikuar nga neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale, si dhe është kompetente për shqyrtimin e akuzave penale në të cilat akuza në gjykim përfaqësohet nga prokuroria, si dhe për gjykimin e akuzave penale të viktimës akuzuese, të ngritura ndaj një subjekti të posaçëm, sipas nenit 59 të K.Pr.Penale. Kjo ka sjellë si rrjedhojë, një rritje të numrit të çështjeve të regjistruara në GJKKO, kryesisht për veprat penale të parashikuara nga nenet 119 dhe 120/2 të Kodit Penal.

2. GJKKO ka në kompetencën e saj të shqyrtimit edhe kërkesat për marrjen e masave parandaluese me karakter pasuror, në kuadër të ligjit nr.10192, datë 03.12.2009 *“Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”*.

3. GJKKO është gjykata kompetente edhe për shqyrtimin e kërkesave të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, për marrjen e masave parandaluese personale dhe pasurore, sipas parashikimeve të Aktit Normativ Nr.1, datë 31.01.2020 *“Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit dhe sigurisë publike”*.

▪ **Kriteret e veçanta që duhet të përmbushin gjyqtarët e GJKKO-së.**

Kandidatët për gjyqtarë në GJKKO, referuar parashikimeve ligjore të Ligjit nr.96, viti 2016, *“Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, në Republikën e Shqipërisë”*, duhet të plotësojnë kriteret minimale si më poshtë vijojnë për përvojën profesionale: magjistrati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet si gjyqtar, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar në fushën e drejtësisë penale ose si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar.

Në këtë kontekst, kandidatët për gjyqtarë në GJKKO, referuar parashikimeve ligjore të Ligjit Nr.95/2016, *“Për Organizimin dhe funksionimin e Institucioneve për të luftuar Korrupsionin dhe*

*Krimin e Organizuar*”, i ndryshuar, i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve të sigurisë përpara emërimit në detyrë, përpara se të caktohet apo punësohet në pozicionin e mësipërm. Asnjë kandidat nuk mund të caktohet në detyrë ose të punësohet pa plotësuar këto kushte.

Po kështu, lidhur me detyrimet ligjore që kandidatët e mësipërm duhet të përmbushin përpara emërimit, vlen të theksohet paraqitja dhe firmosja e deklaratës përkatëse me shkrim për heqjen dorë nga e drejta e tyre për privatësi në telekomunikimet e tyre dhe në të dhënat financiare, të pasqyruara në shtojcat B1 e B2 të ligjit të sipërcituar.

Organi kompetent për emërimin e gjyqtarëve në Gjykatat e Posaçme është Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe para emërimit, kandidatët e mësipërm i nënshtrohen verifikimit të pasurisë dhe figurës, si dhe japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikacione vetjake sipas ligjit.

Në zbatim të dispozitave përkatëse të Ligjit nr.96, viti 2016, *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, gjyqtarëve të Gjykatave për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme dhe Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit u sigurohet mbrojtja personale sipas kërkesës, si më poshtë:

- a) Kryetarët e Gjykatave, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme dhe Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit mbrohen me shoqërim, me oficer e nënoficer;
- b) gjyqtarët dhe prokurorët mbrohen me shoqërim, me oficer.

Po kështu, në këtë aspekt, vlen të theksohet se me VKM nr. 478, datë 10.07.2019 *“Për procedurën e sigurisë së gjyqtarëve të Gjykatave kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, të prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme dhe Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit”*, gjyqtarëve iu garantohet mbrojtje personale me shoqërim, me një trupë të nivelit të mesëm nga Garda e RSH-së dhe në raste të veçanta sigurohet mbrojtje për anëtarët e familjes dhe banesave të tyre.

Me iniciativën e Zëvendëskryetares së gjykatës, për amendimin e VKM-së nr. 389, datë 12.06.2019 *“Për kriteret për lëshimin e pasaportës diplomatike dhe asaj të shërbimit”*, aktualisht, gjyqtarët e GJKKO-së janë pajisur me pasaporta diplomatike, duke u lehtësuar ndjeshëm procedurat e udhëtimit të tyre në vendet e BE-së.

GJKKO ka në organikë një staf prej 65 punonjësish, nga të cilët 16 gjyqtarë dhe 49 punonjës të Administratës Gjyqësore, sipas pozicioneve përkatëse. Edhe për nëpunësit civil gjyqësor të administratës ka nisur procesi i verifikimit të kushteve të sigurisë dhe figurës së tyre nga Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve.



Gjatë vitit 2023, GJKKO është përballur me një volum të madh pune, i krijuar si rezultat edhe i numrit të reduktuar të gjyqtarëve. Gjatë vitit 2023, numri faktik i gjyqtarëve të GJKKO-së ka qenë 9 (nëntë) të tillë, nga të cilët 6 (gjashtë) të emëruar dhe 3 (tre) me skemë delegimi, të cilët nga muaji korrik e në vijim i vitit 2023 janë emëruar definitivisht nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Në funksion të mbarëvajtjes së punës, GJKKO është mbështetur maksimalisht nga ana e KLGJ-së, që i është përgjigjur në kohë shumë të shpejtë kërkesave për plotësimin e trupave gjykues, si dhe kërkesave të tjera në funksion të zhvillimit të procesit normal të punës.

#### **- Siguria në gjykatë**

Referuar VKM-së nr.507, datë 27.07.2022, për një shtesë në VKM-në nr. 597, datë 13.10.2021 *“Për përcaktimin e personaliteteve dhe objekteve të tjera, që ruhen dhe mbrohen nga Garda e Republikës së Shqipërisë”*, Garda e Republikës së Shqipërisë ruan dhe mbron Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, e cila garanton sigurinë e personaliteteve shtetërore dhe objekteve në ruajtje.

Në kuadër të garantimit të sigurisë në gjykatë, gjatë vitit 2023, shërbimet e Gardës së Republikës monitoruan në kohë reale, në tre vendndodhje të ndryshme, duke mbuluar kështu në mënyrë të plotë, perimetrin e gjykatës, brenda dhe jashtë ambienteve të saj.

## II. ADMINISTRIMI I GJYKATËS


Administrimi i GJKKO-së realizohet nëpërmjet Këshillit të Gjykatës, Kryetarit dhe Kancelarit, kompetencat e së cilëve parashikohen në ligjin nr. 98, datë 06.10.2016 *“Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar.

### 1. Këshilli i Gjykatës

Këshilli i Gjykatës përbëhet nga Zëvendëskryetari i Gjykatës në cilësinë e Kryetarit të Këshillit dhe dy anëtarë të tjerë, nga Gjyqtarja me vjetërsinë më të madhe në detyrë dhe Kancelari i gjykatës. Ky Këshill mban dhe ushtron kompetencat që parashikon ligji nr. 98/2016 *“Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar. Gjatë vitit 2023, Këshilli ka zhvilluar gjithsej 23 mbledhje, në përfundim të së cilave ka disponuar me 23 vendime.

Me vendimin nr. 147, datë 29.03.2023 *“Për përcaktimin e kategorive të gjykatave”*, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka përcaktuar Gjykatën e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar si gjykatë e **“Kategorisë së parë (e lartë)”**. Në zbatim të Vendimit të KLGJ-së me nr. 148, datë 29.03.2023 *“Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësi të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, kategoria e parë, me zyrë shërbimi”*, Këshilli i GJKKO-së me vendimin nr. 6, datë 07.07.2023 *“Për miratimin e strukturës dhe Organigramës”*, miratoi strukturën dhe organigramën e re të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, e cila pasqyrohet në skemën dhe tabelën e mëposhtme:

# Organigrama e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (65 punonjës)



Organigrama e GJKKO-së

**Tabela: Pozicionet e punonjësve sipas organikës**

<b>Nr.</b>	<b>Pozicioni sipas organikës</b>	<b>Numri</b>
1	Kryetar	1
2	Zv/Kryetar	1
3	Gjyqtarë	14
4	Kancelar	1
5	Kryesekretare	1
6	Sekretare gjyqësore	18
7	Drejtor i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar	1
8	Specialist finance	1
9	Magaznier	1
10	Shef i Sektorit IT, Statistike dhe MPM	1
11	Specialist IT	1
12	Specialist i Marr. me Publikun, Median dhe Jashtë	1
13	Specialist për statistika gjyqësore	1
14	Shef i Sektorit të B.NJ., SH.M. dhe Prokurimeve	1
15	Specialist Burime Njerëzore/Prokurime	1
16	Nëpunës gjyqësorë	5
17	Specialistë të SSHM	3
18	Punonjës sigurie	1
19	Mirëmbajtës	1
20	Shoferë	5
21	Sanitare	3
22	Shef Sektori Protokoll/Arkivë	1
23	Specialist Protokoll/Arkivë	1
<b>Totali</b>		<b>65</b>

Struktura organizative e GJKKO-së për vitin 2023 është e organizuar në një drejtori dhe tre sektorë, konkretisht: Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar; Sektori i Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve; Sektori i IT-së, Statistikave, Marrëdhënieve me Publikun, Mediat dhe me jashtë; Sektori i Protokoll/Arkivit. Me Vendimin e Këshillit të GJKKO-së nr. 8, datë 07.07.2023 “Për Transferimin e përhershëm të nëpunësve civil pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, u bë transferimi i nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të gjykatës sipas strukturës dhe organikës së re. Megjithë riorganizimin e gjykatës, numri i punonjësve të administratës mbeti po i njëjtë, 49 të tillë. Për vitin 2024 i është kërkuar KLGJ-së miratimi i 8 pozicioneve të reja sipas organigramës, kërkesë e cila nuk gjeti miratim.

Gjatë vitit 2023, Këshilli i GJKKO-së ka disponuar me vendimmarrje për sa i përket rekrutimit të dy sekretareve gjyqësore si dhe një specialisti statistikash, nëpërmjet Procedurës së Lëvizjes Paralele, bazuar në Vendimin e KLGJ nr. 622 datë 10.12.2020 *“Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”*.

Gjithashtu Këshilli ka disponuar edhe për çështje që lidhen me administrimin e gjykatës, siç është miratimi i Projekt Buxhetit për periudhën 2024-2026 të GJKKO-së, çështje që kanë të bëjnë me rritjen e sigurisë në ambientet e Gjykatave të Posaçme, si çështje që kanë të bëjnë me veprimtarinë gjyqësore. Lidhur me këtë të fundit, janë zhvilluar në mënyrë të vazhdueshme disa Mbledhje të Përgjithshme të Trupës Gjyqësore, ku pas diskutimeve, është çmuar nga trupa gjyqësore se caktimi dhe ndarja e trupave gjyqësore, do të ishte jo eficient, kjo referuar faktit që: GJKKO mbetet e paplotësuar në organikën e saj, duke pasur aktualisht 9 gjyqtarë nga 16 të tillë; fakti që me ndryshimet e reja që pësoi Kodi i Procedurës Penale në vitin 2021, një pjesë e mirë e gjyqtarëve kanë pengesa për marrjen pjesë në gjykim, duke qenë se më parë kanë mbajtur cilësinë e gjyqtarit të hetimeve apo seancës paraprake (pra, duke qenë të ezauruar); faktin që çështjet e paraqitura për gjykim pranë GJKKO-së shfaqin kompleksitet, shpeshherë, edhe për shkak edhe të numrit të lartë të të pandehurve, që në varësi të gjykimit kushtëzon ndarjen apo pezullimin e çështjes. Në këto rrethana, Këshilli i Gjykatës ka vendosur mos ndarjen e trupave gjyqësore, për shkaqet e cituara më sipër, deri në ndryshimin e tyre.

## **2. Kryetari i Gjykatës**

Kryetari i GJKKO-së ka përgjegjësi për menaxhimin e përgjithshëm gjyqësor. Ai përfaqëson gjykatën në marrëdhënie me të tretët, qofshin këta aktorë vendas, të tillë si OJF të ndryshme, ashtu edhe organizata ndërkombëtare si OSBE, EURALIUS, USAID, që operojnë me projekte të ndryshme në fushën e gjyqësorit shqiptar.

Vlen të theksohet se GJKKO, në funksion të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, ka luajtur një rol thelbësor, veçanërisht lidhur me raportimin e rasteve korrupsionit në nivele të larta të funksionarëve të lartë shtetërorë dhe publikë, si dhe rastet e krimit të organizuar. Në këtë kuadër, nga viti 2022 e në vijim janë zhvilluar një sërë takimesh midis ekspertësh (gjyqtarë dhe prokurorë të Gjykatës dhe Prokurorisë së Posaçme), lidhur me rishikimin kolegjial të çështjeve konkrete të praktikës gjyqësore, për sa i takon misionit të TAIEX, në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Po kështu, në kuadër të njohjes të legjislacionit të zbatueshëm që lidhet me integritetin evropian, jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë dhe GJEDNJ-së, si dhe njohjen dhe zbatimin e standardeve që ato mishërojnë, GJKKO u përfaqësua nëpërmjet Zëvendëskryetares në takimin shpjegues të mbajtur në qytetin e Brukselit, Belgjikë për Kapitullin 23 *“Gjyqësori dhe të drejtat themelore”*, më datë 27.09.2022, si dhe në takimin bilateral të zhvilluar në Bruksel, Belgjikë, po për Kapitullin 23 *“Gjyqësori dhe të drejtat themelore”*, më datat 24 dhe 25.11.2022 si dhe si dhe

takime të tjera në format hibrid gjatë vitit 2023. Gjithashtu, GJKKO u përfaqësua nëpërmjet Zëvendëskryetares në tryezën e rumbullakët të mbajtur në qytetin e Strasburgut, organizuar nga Këshilli i Evropës, me temë *“Risitë dhe praktikat e gjykatave të posaçme dhe gjyqtarëve të posaçëm në fushën e antikorrupsionit”*, më datë 31.10.2023.

Kryetari mbikëqyr respektimin e etikës gjyqësore, disiplinës në punë dhe solemnitetit, duke bashkëpunuar me Këshillin e Lartë Gjyqësor, në lidhje me vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve. Njëkohësisht, ai kujdeset nëpërmjet dhënies së vendimeve dhe urdhrave për të siguruar respektimin e afateve dhe përdorimit sa më të mirë të burimeve të disponueshme, si dhe aksesin dhe transparencën në gjykatë.

Kryetari i gjykatës, në veprimtarinë e Administratës Gjyqësore, kujdeset edhe për organizimin dhe funksionimin e administrimit gjyqësor në gjykatë në lidhje me veprimtaritë jo gjyqësore, nëpërmjet Kancelarit, duke ndjekur disiplinën në punë, përveç se të gjyqtarëve edhe të punonjësve të tjerë të gjykatës dhe për shkeljet e konstatuara vendos për marrjen e masave disiplinore sipas ligjit.

Gjatë vitit 2023, Kryetari i Gjykatës ka nxjerrë një sërë urdhrash të brendshëm, në funksion të mirëorganizimit të gjykatës për planifikimin dhe përdorimin efikas të fondeve publike, sipas nevojave të gjykatës, ka shqyrtuar kërkesat për dorëheqje të gjyqtarëve që kishin pengesa në gjykim, ka miratuar kërkesat për leje të gjyqtarëve etj.

Në drejtimin e Zëvendëskryetares së Gjykatës, znj. Irena Gjoka, gjykata ka realizuar gjithë objektivat dhe pritshmëritë e saj, në drejtim të mbarëvajtjes së punës, si në aspektin administrativ, organizativ dhe atë vendimmarrës, megjithë vështirësitë dhe ngarkesën e krijuar për shkak të vakancave të gjyqtarëve në gjëndjen faktike të organikës së saj.

Veprimtarinë e GJKKO-së ka qenë dhe vijon të mbetet në fokus dhe vëmendje mediatike të lartë, për shkak të rëndësisë së veprave penale që ka në kompetencën e saj funksionale, që lidhen me krimin e organizuar, por dhe format e ndryshme të shfaqjes së korrupsionit, që mbetet një ndër sektorët më problematikë në vend, po kështu edhe për shkak të subjekteve të posaçme që gjykon. Në këtë aspekt, ka pasur pritshmëri të larta, të cilat janë përmbushur më së miri, në funksion të realizimit të qëllimit kryesor të saj që është dhënia e drejtësisë, duke arritur që të sigurojë balancën e duhur, pa cënuar asnjë nga aktorët proceduralë. Si rrjedhim, duke luftuar shfaqjet e reja të formave të kriminalitetit në Shqipëri dhe duke përmbushur nevojën për parandalimin dhe luftimin e tyre, në kuadër dhe të rekomandimeve lidhur me politikën penale që duhet të ndërmerren referuar masave për luftimin e formave të ndryshme të krimit të organizuar dhe korrupsionit, gjykata ka dhënë kontributin e saj edhe në kuadër të plotësisë të kriterëve nga Republika e Shqipërisë, për antarësim në strukturat evropiane, si ajo e BE-së.

Gjatë vitit 2023 nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë u zhvillua inspektimi tematik *“Mbi ndarjen e çështjeve më short, për periudhën 01.01.2022-31.12.2022”* dhe mbetemi në pritje të raportit të këtij Inspektoriati mbi këtë inspektim.

### 3. Kancelari i Gjykatës

Kancelari është përgjegjës për menaxhimin e administrimit gjyqësor. Ai organizon dhe kontrollon veprimtarinë e përditshme të sekretarisë gjyqësore, si dhe të sektorëve ose zyrave të tjera, që bëjnë pjesë në strukturën e gjykatës. Kancelari është përgjegjës për funksionimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve në gjykatë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për teknologjinë dhe sigurinë e informacionit, mbikëqyrjen e mbledhjes dhe përpunimit të saktë të të dhënave, si dhe kujdeset për çështjet e etikës dhe përmbushjes së detyrave nga ana e administratës gjyqësore, gjatë dhe jashtë pjesëmarrjes në gjykim. Duhet theksuar fakti se është punuar maksimalisht dhe në mënyrë të vazhdueshme në këtë aspekt, nëpërmjet rritjes së kërkesës së llogarisë dhe monitorimit të proceseve të punës të administratës gjyqësore, duke përdorur mënyra efikase dhe produktive në funksion të mbarëvajtjes në punë, si mbledhjet me stafin, nëpërmjet një procesi proaktiv, ku dhënia e mendimeve dhe ideve të reja nga ana e administratës ka qenë në qendër të vëmendjes së Kancelarit të GJKKO-së. Gjithashtu, vlen të vihet në dukje fakti se janë zhvilluar edhe takime me grupe pune dhe takime individuale me punonjës të administratës gjyqësore, në kuadër të diskutimit të çështjeve të ndryshme, për efekt të mbarëvajtjes në punën e përditshme.

Kancelari gjithashtu kryeson Komisionin për Kthimin dhe Asgjësimin e Provave Materiale dhe mbikëqyr procesin e ruajtjes dhe asgjësimit të tyre, sipas urdhërimeve të vendimeve gjyqësore.

Gjithashtu, Kancelari kontrollon realizimin e detyrave nga ana e nëpunësve civilë gjyqësorë, lidhur me kryerjen e njoftimeve procedurale, si dhe përmbushjen e urdhërimeve të gjykatës mbi zhvillimin e gjykimit. Në këtë aspekt, është ndjekur respektimi i ligjit dhe rregullores së gjykatës dhe kur është konstatuar moszbatimi i tyre janë aplikuar sipas rastit masa disiplinore.

Rritja e standardeve dhe e performancës në punë të stafit të administratës së GJKKO-së, ka si qëllim krijimin e një ambienti të shëndetshëm, të sigurt dhe të përgjegjshëm pune, duke reflektuar tek publiku faktin se administrata gjyqësore e mbështet veprimtarinë e saj në parimet e profesionalizimit, paanësisë, të transparencës, të shërbimit ndaj publikut, të përgjegjësisë dhe korrektësisë në zbatimin e legjislacionit në fuqi.

Gjatë vitit 2023, Kancelari ka raportuar periodikisht në KLGJ dhe Ministrinë e Drejtësisë lidhur me çështjet mbi administrimin e gjykatës dhe çështje të statistikave gjyqësore.

Gjithashtu, Kancelari ka përfaqësuar GJKKO-në trajnimin e zhvilluar më datë 06.03.2023 në Ispra, Itali, organizuar nga Komisioni Evropian, mbi ndërtimin e kapaciteteve për metodologjinë e re për track-record-et, mbledhjen e të dhënave mbi krimet e rënda, krimin e organizuar dhe korrupsionin në nivele të larta. Trajnim i mësipërm ka pasur si synim implementimin e një platforme të re për të përcjellë në kohë reale pranë shërbimeve të Komisionit Evropian, të dhëna statistikore lidhur me korrupsionin dhe krimin e organizuar.

#### **4. Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve**

Gjatë vitit 2023 janë zhvilluar 9 (nëntë) Mbledhje të Përgjithshme të Gjyqtarëve, të cilat në tërësi kanë trajtuar tema që lidhen me ndarjen e trupave gjykues; të drejtën e informimit dhe medias; përmirësimin e komunikimit të marrëdhënieve me publikun dhe me mediat për të siguruar një marrëdhënie proaktive, transparente e informuese, nëpërmjet gjyqtarit të medias, nevojat që kanë gjyqtarët në funksion të kryerjes së veprimtarisë në kuadër të përgatitjes së projekt-buxhetit për vitet e ardhshme 2024 -2026; problematikat e shfaqura gjatë shqyrtimit të çështjeve gjyqësore në aspekt material dhe procedural etj.



### III. EFIKASITETI I PUNËS PERGJATË VITIT 2023, KRAHASIMI ME VITET 2022 DHE 2021.

Analiza vjetore ofron një pasqyrë të gjendjes aktuale lidhur me punën e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (në vijim GJKKO). Analiza përmban edhe vlerësim për punën e gjyqtarëve të GJKKO-së lidhur me efikasitetin e punës së tyre, duke trajtuar të gjitha aspektet e veprimtarisë, përfshirë strukturimin dhe organizimin e GJKKO-së, çështje të personelit, të buxhetit, të sistemit të IT-së, komunikimit dhe koordinimit, të rregullave procedurale përmes të cilave institucioni ushtron funksionin e tij, të transparencës.

Analiza e përgjithshme për periudhën dhe rezultatet vjetore është përshkruar në formë analitike dhe krahasimore bazuar në të dhënat/raportet e mëparshme sipas vendimit nr. 47 datë 11.02.2021 të KLGJ-së *“Për miratimin e udhëzuesit për mbajtjen dhe plotësimin e tabelave me të dhëna statistikore për efekt të matjes dhe monitorimit të produktivitetit dhe efijencës së gjykatave”* dhe sipas udhëzimit të *“CEPEJ për statistikat gjyqësore”*, miratuar nga CEPEJ në mbledhjen plenare të 12të (Strasburg, 10 - 11 dhjetor 2008). Në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar rezultoi se gjatë vitit 2023, janë 7 (shtatë) pozicione vakante për gjyqtar dhe vijojnë procedura për plotësimin e tre vendeve vakante nga KLGJ-ja.

#### 1) Burimet njerëzore

Në funksion të menaxhimit sa më të mirë të burimeve njerëzore dhe të mirëadministrimit të gjykatës, situata e burimeve njerëzore gjatë vitit 2023 paraqitet si në tabelë,

Nr. i gjyqtarëve sipas dekretit	Nr. i gjyqtarëve efektivisht në detyrë	Efektiv vs dekreti në %	Nr. i stafit mbështetës sipas organikës	Nr. i stafit mbështetës efektivisht në detyrë	Efektiv vs organika në %	Staf mbështetës për gjyqtar sipas organikës	Staf mbështetës për gjyqtar në fakt.
16	9	56%	49	46	94%	3.1	5.1

ku vihet re se Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka plotësuar strukturën në masën 56% të organikës së gjyqtarëve (9% më tepër se viti paraardhës) dhe me 94% të organikës së stafit mbështetës (1% më tepër se viti paraardhës).

Raporti staf mbështetës për çdo gjyqtar efektivisht në detyrë është 5.1% (1 staf efektiv më pak se viti paraardhës).

Ky raport është ulur krahasuar me një vit më parë, por mbetet sërish me 2 nëpunës më tepër krahasuar me raportin e planifikuar në organikë, ku një gjyqtar asistohet mesatarisht nga 3.1 nëpunës.

## 2) Menaxhimi i çështjeve.


Në vitin 2023 gjykata ka filluar shqyrtimin e çështjeve me 152 çështje të mbartura, përkatësisht:

- 61 Krime,
- 77 Kërkesa Penale Administrative,
- 14 Çështje të ligjit antimafia.

Ky numër krahasuar me vitet e kaluara, viti 2021 – 158 çështje dhe viti 2022-181 çështje, vihet re një rënie prej 6%, duke qenë se në vitin 2023, është rritur numri i gjyqtareve efektiv në detyrë nga 7.5 në 9 gjyqtar.

Më poshtë jepen tabelat me të dhënat konkrete dhe krahasuese.


Çështje të mbartura 2021, 2022 dhe 2023 - BACK-log											
Krime			Penale Administrative			Çështje te ligjit antimafia			TOTTAL		
2021	2022	2023	2021	2022	2023	2021	2022	2023	2021	2022	2023
55	50	61	95	124	77	8	7	14	158	181	152
35%	28%	40%	60%	69%	51%	5%	4%	9%	32%	37%	31%



### 3) Natyra e Backlog-ut.

GJKKO ka vijuar intensivisht punën në lidhje me reduktimin e çështjeve të prapambetura. Rezultoni se 51 % e tyre i përkasin kategorisë së çështjeve penale administrative në krahasim me një vit më parë, ku stoku përbëhej në masën 68 % çështje penale administrative. Vërehet se çështjet e ligjit antimafia vijojnë të zënë përqindjen më të vogël të stokut, në masën 9%. Volumi i kategorisë së krimeve është në masën 40 % në vitin 2023, i cili është rritur në ndryshim nga viti 2022 - 28% dhe 35% në vitin 2021, kjo për arsye se që lidhen me:

- Natyrën dhe kompleksitetin e çështjeve (numri i lartë i të pandehurve, procedurat e njoftimit, numri i dëshmitareve, etj.)
- Kohëzgjatjet e gjykimit në rastet e gjykimit të zakonshëm, i cili në Gjykatën e Posaçme aplikohet përveç të tjerash edhe për shkak të ligjit, sipas nenit 403 të Kodit të Procedurës Penale.
- Përfshirja e çështjeve të pezulluara sipas nenit 352 të Kodit të Procedurës Penale.
- Tendencën e prokurorisë për depozitimin e çështjeve në fund të vitit kalendarik.




#### 4) Çështje të reja

Gjatë vitit 2023 janë regjistruar 2775 çështje, nga të cilat:

- 73 Krime,
- 2667 Kërkesa Penale Administrative,
- 35 Çështje të ligjit antimafia.

Sa i përket llojit të çështjeve të reja të paraqitura në gjykatë, situata paraqitet grafikisht si më poshtë.




Rezultoni se 96% e çështjeve të regjistruara i përkasin kategorisë së çështjeve penale administrative, 3% janë krime dhe 1% çështje të ligjit antimafia. Vërehet se raporti mes kategorive është i pothuajse i njëjtë me vitet e kaluara.

Ndryshimi thelbësor është në numrin e çështjeve të reja të cilat kanë një rritje prej 716 çështjesh, në raport me vitin paraardhës, nga të cilat kërkesat penale administrative zënë pjesën më të madhe.

Çështje të reja të regjistruara 2021, 2022 dhe 2023											
Krime			Penale Administrative			Çështje te ligjit antimafia			TOTAL		
2021	2022	2023	2021	2022	2023	2021	2022	2023	2021	2022	2023
94	89	73	2074	1942	2667	35	28	35	2203	2059	2775
4%	4%	3%	94%	94%	96%	2%	1%	1%	31%	29%	40%


Nëse krahasojmë numrin e çështjeve të reja në tre vite (2021, 2022 dhe 2023) rezulton se 40% e tyre i përkasin vitin 2023.



## 5) Ngarkesa e gjykatës:

Përgjatë vitit 2023 janë shqyrtuar në total 2927 çështje, shumë kjo e përbërë nga çështje të mbartura nga viti 2022 (152 çështje) dhe çështjet e reja të paraqitura në këtë gjykatë gjatë vitit 2023 (2775 çështje). Këto shifra janë të detajuara më poshtë ku numri i çështjeve penale administrative zë peshën kryesore, me 96%.

Ngarkesa e Gjykatës 2023									
Krime		Total	Penale Administrative		Total	Çështje të ligjit antimafia		Total	TOTAL
Mbartur	Të reja		Mbartur	Të reja		Mbartur	Të reja		
61	73	134	77	2667	2744	14	35	49	2927



## 6) Ngarkesa mesatare e punës (Treguesi WR),

Ngarkesa mesatare e punës për gjyqtar, tregon numrin mesatar të çështjeve në ngarkim për çdo gjyqtar efektivisht në detyrë. Ky indikator përcaktohet nga raporti i ngarkesës totale në gjykatë (backlog dhe çështje të reja të regjistruara) me numrin e gjyqtarëve efektivisht në detyrë.

Për vitin 2023 ngarkesa mesatare e punës rezulton 325 çështje për gjyqtar. Krahasuar me vitin 2022 ngarkesa mesatare e punës është rritur nga 299 në 325 çështje, me rritje prej afërsisht 9%. Kjo rritje e ngarkesës është ndikuar kryesisht nga numri i kërkesave penale administrative të reja, të cilat krahasuar me vitet e kaluar janë rreth ~700 çështje më shumë, edhe pse numri efektiv i gjyqtareve është rritur nga 7.5 në 9.

Numri gjyqtarëve efektiv 2021	Numri i gjyqtarëve efektiv 2022	Numri i gjyqtarëve efektiv 2023	WR 2021	WR 2022	WR 2023
7.16	7.5	9	329.7	298.7	325

## 7) Vjetërsia e çështjeve në pritje për gjykim:

Edhe pse e plotësuar vetëm me 56 % të organikës së gjyqtarëve, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka arritur përmirësim të dukshëm të çështjeve të mbartura për vitin 2024. Në fund të periudhës raportuese gjykata ka gjykuar gjithsej një numër prej 2801 çështjesh ose 96 % të ngarkesës gjithsej të gjykatës duke mbartur për shqyrtim në vitin 2024 një stok prej 126 çështjesh. Rezulton se 75% e çështjeve të prapambetura përbëhet nga çështjet e reja të regjistruara gjatë 2023 nga të cilat, 20 % janë çështje të regjistruara në 6 mujorin e dytë të vitit 2023 dhe, 18 çështje ose 14 % e çështjeve të prapambetura, janë në pritje të gjykimit prej më shumë se një viti dhe, vetëm 14 çështje prej më shumë se 2 vitesh. Vlen të theksohet fakti se në gjykatë janë përfunduar të gjitha çështjet me vjetërsi më shumë se 3 vjet në raport me vitet e kaluara.

Po kështu ne lidhje me çështjet 2-3 vjet, ku rezulton se nga 14 çështje, nga të cilat 6 janë të llojit krime ndërsa 8 janë kërkesa penale administrative, këto të fundit i përkasin kërkesave me objekt konfiskim pasurie sipas Aktit normativ nr. 1 datë. 31.01.2020 “Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimin të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike”, të cilat zgjasin në kohë për shkak të kompleksitetit.

VJETËRSIA E ÇËSHTJEVE NË PRITJE TË GJYKIMIT							
Lloji i çështjes	NUMRI I ÇËSHTJEVE NË PRITJE TË GJYKIMIT						
	Në pritje të	< 6 muaj	6-12 muaj	1-2 vjet	2-3 vjet	3-5 vjet	> 5 vjet
A Krime	46	20	11	9	6	0	0
B Kundërvajtje penale	0						
C Çështje penale administrative	69	44	13	4	8	0	0
D Çështje të ligjit antimafia	11	5	1	5		0	0
<b>ÇËSHTJE PENALE GJITHSEJ (A+B+C+D)</b>	<b>126</b>	<b>69</b>	<b>25</b>	<b>18</b>	<b>14</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

Për sa i përket çështjeve në pritje të gjykimit, rezulton se gjykata ka përmirësuar ndjeshëm afatet kohore të gjykimit.



## 8) Treguesit e efijencës

### Treguesi ER ose rendimenti mesatar i punës për gjyqtar:

Ky tregues shpreh numrin mesatar të çështjeve të gjykuara nga çdo gjyqtar efektivisht në detyrë, gjatë periudhës raportuese. Për vitin 2023, treguesi ER për Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është 311 çështje për gjyqtar.

Rezultoni rritje e rendimentit mesatar të punës për gjyqtar në krahasim me vitin 2022, me 11.7%, pavarësisht rritjes së numrit të çështjeve.

Gjyqtarë 2021	Gjyqtarë 2022	Gjyqtarë 2023	ER 2021	ER 2022	ER 2023	# në % i ER
7.16	7.5	9	304.5	278.4	311	11.7%


## Treguesi CR ose norma e zgjidhjes së çështjeve:

Raporti i përfituar nga pjesëtimi i numrit të çështjeve të zgjidhura (përfunduara), me numrin e çështjeve të regjistruara (çështjeve të reja) e shprehur kjo në përqindje. Rëndësia e këtij treguesi është shumë domethënëse sepse nëpërmjet tij arrihet në konkluzion nëse gjykata është duke krijuar stok apo duke e ulur atë.

Për Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në vitin 2023 ka pasur një normë të lartë në likuidimi të çështjeve duke mbajtur vlerën 101% sikurse në vitin 2022. Vlen për t'u theksuar fakti që edhe pse numri i çështjeve të reja ka qenë shumë i lartë, norma e likuidimit të çështjeve ka qenë në ~110% për çdo kategori.

Lloji i çështjes	Administrimi i çështjeve				Treguesit e efijçencës	
	Në pritje të gjykimit në fillim të periudhës	Çështje të reja të paraqitura në gjykatë	Të gjykuara	Në pritje të gjykimit në fund të periudhës	Të regjistruara gjithsej	Norma e likuidimit të çështjeve (%)
Krime	61	73	88	46	134	<b>121</b>
<i>Korrupsioni</i>	26	44	51	19	70	116
<i>Krimi i organizuar</i>	28	20	22	28	48	110
Çështje penale administrative	77	2667	2675	69	2744	<b>100</b>
Çështje të ligjit antimafia	14	35	38	11	49	<b>109</b>
Total	152	2775	2801	126	2927	<b>101%</b>

Gjykata duke mbajtur normën e lartë të gjykimit tregon që është në zvogëlim e sipër të stokut të çështjeve.



## Treguesi DT ose koha e nevojshme për përfundimin/likuidimin e çështjeve (*case disposition time*)

Treguesi mat se sa shpejt gjykata punon mbi çështjet e marra, pra nënkupton kohën që duhet për përfundimin e një lloji çështjeje të caktuar. Për vitin 2023 koha mesatare e zgjidhjes së çështjes është 16 ditë, kjo ulur ndjeshëm nga vitet e kaluara.

- Viti 2023 – 16 ditë
- Vitin 2022 – 26.6 ditë
- Vitin 2021 – 30.3 ditë.


Referuar llojeve të çështjeve për të cilat ka interes, rezulton se për kategorinë krime/korrupsion kohëzgjatja për përfundimin e çështjeve në vitin 2023 është 136 ditë, në raport me 316 ditë të vitit paraardhës, duke u ulur ndjeshëm me 180 ditë.

Për llojin e çështjeve për kategorinë Krim i Organizuar kohëzgjatja për përfundimin e çështjeve në vitin 2023 është 431 ditë, në raport me 511 ditë të vitit paraardhës, duke u ulur me 80 ditë.

Për llojin e çështjeve për kategorinë e Ligjit antimafia kohëzgjatja për përfundimin e çështjeve në vitin 2023 është 106 ditë, në raport me 243 ditë të vitit paraardhës, duke u ulur me 137 ditë.

Më poshtë tabela me të dhënat specifike.

Koha e nevojshme për evadimin e çështjeve DT								
Korrupsioni			Krimi i Organizuar			Çështje të ligjit antimafia		
DT 2021	DT 2022	DT 2023	DT 2021	DT 2022	DT 2023	DT 2021	DT 2022	DT 2023
104	316	136	407	511	431	71	243	106



## **GJETJET KRYESORE!**

- ✓ Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar e ka nisur punën në janar 2023 me 152 çështje në pritje të gjykimit (backlog), **29 çështje më pak**, krahasuar me backlog-un në fillim të vitit 2022.
- ✓ Në gjykatë janë regjistruar 2775 çështje të reja, 716 ose **25% çështje më shumë** krahasuar me vitin paraardhës.
- ✓ Rritja e numrit efektiv të gjyqtarëve në vitin 2023, në krahasim me vitin paraardhës ka sjellë rritjen e tërësisë së treguesve të efikasitetit në gjykatë:
  - ngarkesa mesatare për gjyqtar (WR) është 325 çështje;
  - rendimenti mesatar për gjyqtar (ER) është 311 çështje;
  - norma e likuidimit të çështjeve (CR) është 101%;
  - koha mesatare e nevojshme deri në zgjidhjen e një çështjeje (DT) e përgjithshme është 16 ditë.

Në fund të vitit raportues 2023, në këtë gjykatë mbeten në pritje për t'u shqyrtuar 126 çështje, nga 152 që ishin në vitin 2022.

#### IV. VEPRIMTARIA E GJYKATËS, AFATET KOHORE PROCEDURIALE DHE VLERËSIMI

##### 1. Çështjet e paraqitura në gjykatë, kohëzgjatja, statistika mbi ankimin.

Numri i çështjeve të gjykuara nga GJKKO për vitin 2023 paraqitet si më poshtë:

Lloji i çështjeve		Çështje Penale	Seanca Paraprake	Kërkesa Penale	OFL	Masa sigurimi	Kërkesa për përgjime	Sekuesetro/Konfiskim sipas ligjit antimafia
Numri gjithsej	Çështje në pritje më 1 (një) Janar 2023	61	32	17	29	0	0	14
	Çështje në pritje më 31 (tridhjetë e një) Dhjetor 2023	46	39	22	8	0	0	11
	Çështje të ardhura përgjatë viti 2023	73	97	513	3	140	1913	35
	Çështje të përfunduara përgjatë viti 2023	88	90	508	24	140	1913	38

Tabela: Statistika mbi shpejtësinë e përfundimit të çështjeve penale

Shpejtësia e gjykimit të çështjeve penale, për vitin 2023				
Lloji i Çështjes	0 - 6 muaj	6-12 muaj	Mbi 1 vit	Total
Penale Themeli	62	13	13	<b>88</b>
Në %	70%	15%	15%	<b>100%</b>

##### 2. Statistika penale (çështje penale, seanca paraprake, masa sigurimi, kërkesa te tjera penale).

Tabela: Treguesit Statistikorë sipas Bashkimit Evropian 01.01.2023 - 31.12.2023

Lloji i Çështjes	Nr. i çështjeve të përfunduar me 31 Dhjetor 2023	Nr. i çështjeve në gjykim me 31 Dhjetor 2023	Nr. i çështjeve të regjistruar gjatë vitit 2023
Dosje Penale Themeli	88	46	134
Seanca paraprake	90	39	129
OFL	24	8	32
Sekuestro/konfiskim sipas ligjit antimafia	38	11	49
Masa Sigurimi	140	-	140
Kërkesa penale	508	22	530
Përgjime	1913	-	1913
<b>Totali</b>	<b>2801</b>	<b>126</b>	<b>2927</b>


**Tabela: Volumi i çështjeve gjyqësore sipas secilit gjyqtar të GJKKO**

Nr.	Gjyqtar	Nr. çështjeve të mbartura nga vitet e mëparshme	Nr. çështjeve të regjistruara të reja (nga data 1 janar 2023)	Nr. çështjeve të gjykuara	Nr. çështjeve në shqyrtim
1	Irena GJOKA	18	374	377	15
2	Flora HAJREDINAJ	23	227	238	12
3	Etleva DEDA	26	254	267	13
4	Erjon ÇELA	18	416	422	12
5	Erjon BANI	15	329	333	11
6	Atalanta ZEQRIRAJ	13	521	522	12
7	Flojera DAVIDHI	15	285	289	11
8	Elsa ULLIRI	7	145	143	9
9	Rudina PALLOJ	9	199	189	19
10	Albert MEÇA (i deleguar)	-	1	-	1
11	Artan ÇUPI (i deleguar)	1	1	2	-
12	Artan JAHOLLARI (i deleguar)	-	3	1	2
13	Aurel ARAPI (i deleguar)	2	5	5	2
14	Diamela GOXHA (e deleguar)	-	7	8	1
15	Edvan VEÇANI (i deleguar)	-	-	1	-
16	Esmeralda XHILI (e deleguar)	1	-	-	1
17	Migena LASKA (e deleguar)	1	1	1	1
18	Matilda LLANGOZI (e deleguar)	-	1	-	1
18	Paulin ÇERA (i deleguar)	-	6	3	3
<b>TOTALI</b>		<b>152</b>	<b>2775</b>	<b>2801</b>	<b>126</b>

**Tabela: Volumi i çështjeve penale ne vitin 2023**

Volumi çështjeve penale të reja përgjatë vitit 2023							
Seanca paraprake	Çështje Penale	Kërkesa Penale	OFL	Sekuestro / Konfiskim	Masa Sigurimi	Përgjime	Totali
97	73	513	4	35	140	1913	2775


**Grafiku: Volumi i çështjeve penale dhe hetimeve paraprake në vitin 2023**



**Tabela: Masat e sigurimit të vendosura nga gjykata**

Masa Sigurie	Të Regjistruara	Të Përfunduara	Të Papërfunduara
<b>Totali</b>	140	140	0

**Grafiku: Masat e sigurimit të vendosura nga gjykata**






**Tabela : Detajimi i mënyrës së përfundimit të çështjeve penale 2023**

Viti 2023	Me vendim fajësie	Me vendim pafajësie	Vendim Pushimi	Kthim për plotësim hetimesh	Vendosur moskompetenca	Totali
Sasia në nr. çësht.	67	8	7	0	6	<b>88</b>
Sasia në %	76%	9%	8%	0%	7%	<b>100%</b>

**Grafiku : Detajimi i mënyrës së përfundimit të çështjeve penale 2023**



Nga ana e GJKKO-së, gjatë vitit 2023, është disponuar me vendim për 272 persona, prej nga rezulton se me vendime dënimi, janë dënuar 227 persona, me 8 vendime pafajësie janë shpallur 32 persona të pafajshëm dhe me 7 vendime pushimi është pushuar çështja për 7 persona.


**Tabela : Detajimi i gjyimit të të pandehurve sipas akuzave, neneve te Kodit Penal.**

Personat e gjykuar për vitin 2023, sipas neneve të Kodit Penal	Të dënuar	Pafajësi	Pushuar	Moskompetence
Neni 78/2	2	-	-	-
Neni 79/a	2	-	-	-
Neni 79/dh	6	-	-	-
Neni 119	-	-	-	1
Neni 120	-	5	6	-
Neni 140	1	-	-	-
Neni 141, 333/a	5	1	-	-
Neni 144/a	-	-	-	1
Neni 186	3	1	-	-
Neni 190	1	-	-	-
Neni 199/a/1	1	-	-	-
Neni 232/a	3	-	-	-
Neni 244/2	7	1	-	-
Neni 245/1/2	31	-	-	-
Neni 248	24	2	-	4
Neni 257/a/1	1	-	-	-
Neni 258	21	11	-	-
Neni 259	39	6	-	-
Neni 260	2	1	-	-
Neni 283/a/1, 283/a/2, 333/a	26	2	1	-
Neni 284	3	1	-	-
Neni 287/a/1	4	1	-	-
Neni 298	23	-	-	-
Neni 300, 301	2	-	-	-
Neni 312	2	-	-	-
Neni 319	6	-	-	-
Neni 319/ç	5	-	-	-
Neni 328	7	-	-	-
<b>Total</b>	<b>227</b>	<b>32</b>	<b>7</b>	<b>6</b>

**Tabela : Detajimi i masave të dënimit të dhëna nga gjykata**

Me gjobë	Deri 2 vjet	2-5 vjet	5-10 vjet	10-25 vjet	25-35 vjet	Burgim i përjetshëm	TOTALI
3	125	41	42	5	4	7	227


**Grafiku : Detajimi i masave te dënimit të dhëna nga gjykata**



**Tabela : Detajimi i dënimeve të dhëna sipas gjinisë**

Sasia	Të dënuara femra	Të dënuar meshkuj	Të dënuar gjithsej
Në numër	14	213	227
Në %	6%	94%	100%

**Grafiku : Detajimi i dënimeve të dhëna sipas gjinisë**




**Tabela: Çështje penale të regjistruara gjithsej sipas dispozitave përkatëse penale për vitin 2023**

Nenet	Emërtimi i Nenit	Çështje të regjistruara	Çështje të përfunduara me vendim	Çështje të mbartura në 2024
78/a; 78/2; 333/a	Vrasje për gjakmarrje; Vrasja me paramendim, e kryer për interes, hakmarrje a gjakmarrje	7	3	4
79/a; 79/dh; 333/a	Vrasje e funksionareve publik; Vrasje në rrethana të tjera cilësuese - kundër dy ose më shumë personave	5	2	3

109/3; 333/a	Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit nën moshën 14 vjeç, i paraprirë a shoqëruar me tortura fizike ose psikike, i kryer kundër disa personave ose më shumë se një herë	1	-	1
134/3; 139; 140; 333/a	Vjedhja; Vjedhja me dhunë; Vjedhja me armë	4	2	2
186/2; 186/1; 189/2; 333/a	Përdorimi i dokumenteve të falsifikuara; Falsifikimi i dokumenteve; Përdorimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave të falsifikuara	2	1	1
244	Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike	6	5	1
245/1/2	Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike	6	6	
248	Shpërdorimi i detyrës	13	9	4
258	Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike	6	6	
259	Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike	16	13	3
283/a/1, 283/a/2; 333/a	Trafikimi i narkotikëve, në bashkëpunim ose më shumë se një herë	13	9	4
284/1; 333/a	Kultivimi i bimëve narkotike	4	1	3
287/a	Çelja e llogarive anonime	2	2	

289/3; 289/2, 333/	Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit, në bashkëpunim, më shumë se një herë ose me pasoja të rënda; Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit, e dhënë për qëllime fitimi	5	3	2
319/ç	Korrupsioni pasiv i gjyqtareve, prokuroreve dhe funksionareve të tjerë të organeve të drejtësisë	5	4	1
319	Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë	1	-	1
119/1	Fyerja	3	2	1
120/1; 120/2	Shpifja; Shpifja botërisht, në dëm të disa personave, ose më shumë se një herë	12	10	2
257/a/2	Refuzimi për deklarin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë	5	1	4
257/a/1		4	-	4
328/1	Dhënia e shpërblimeve dhe premtimeve	8	6	2
312		1		1
232, 234		5	3	2
<b>Totali</b>		<b>134</b>	<b>88</b>	<b>46</b>

**Grafiku : Çështje penale të regjistruara gjithsej sipas dispozitave përkatëse penale për vitin 2023**



**Tabela : Disa prej çështjeve penale sipas llojit të vendimit**

Lloji i veprave penale sipas neneve	Me vendim fajësie	Me vendim pafajësie	Pushuar	Moskompetence
Vrasje për gjakmarrje; Vrasja me paramendim, e kryer për interes, hakmarrje a gjakmarrje	3	-	-	-
Vrasje e funksionareve publik; Vrasje në rrethana të tjera cilësuese - kundër dy ose më shumë personave	2	-	-	-
Vjedhja; Vjedhja me dhunë; Vjedhja me armë	2	-	-	-
Përdorimi i dokumenteve të falsifikuara; Falsifikimi i dokumenteve; Përdorimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave të falsifikuara	1	-	-	-
Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike	5	-	-	-
Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike	6	-	-	-
Shpërdorimi i detyrës	5	-	-	4
Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike	4	2	-	-
Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike	13	-	-	-
Trafikimi i narkotikëve, në bashkëpunim ose më shumë se një herë	7	1	1	-
Kultivimi i bimëve narkotike	1	-	-	-
Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit, në bashkëpunim, më shumë se një herë ose me pasoja të rënda; Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit, e dhënë për qëllime fitimi	3	-	-	-
Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë	4	-	-	-
Shpifja; Shpifja botërisht, në dëm të disa personave, ose më shumë se një herë	-	5	6	-
Fyerja	-	-	-	1
Dhënia e shpërblimeve dhe premtimeve	6	-	-	-



Korrupsioni aktiv i dëshmitarit	1	-	-	-
Nxitjes, thirrjes dhe propagandës për kryerjen e veprave me qëllime terroriste", ne bashkëpunim " parashikuar nga nenet 232/a-25, të Kodit Penal.	3	-	-	-
Krijimi i skemave mashtruese në lidhje me tatimin mbi vlerën e shtuar	-	-	-	1
Refuzimi për deklarinimin, mosdeklarimin, fshehja, ose deklarimi i rremë	1	-	-	-
<b>Totali</b>	<b>67</b>	<b>8</b>	<b>7</b>	<b>6</b>

**Tabelat e cilësisë së gjyqimit të çështjeve të gjykuara në apel për vitin 2023**

<b>Çështje penale të ankimuar</b>				
<b>Përfunduar në gjykatën e Apelit</b>				<b>Aktualisht në Apel</b>
Lënie në fuqi	Ndryshuar	Prishur e kthyer për rigjykim	Prishur dhe pushuar	
29	3	-	-	
Sasia 32				
<b>Totali 51</b>				

<b>Seanca paraprake të ankimuar</b>		
<b>Përfunduar në gjykatën e Apelit</b>		<b>Aktualisht në Apel</b>
Lënie në fuqi	Ndryshuar	
1	1	
Sasia 2		
<b>Totali 3</b>		

<b>Kërkesa penale të ankimuara</b>				
<b>Përfunduar në gjykatën e Apelit</b>				<b>Aktualisht në Apel</b>
Lënie në fuqi	Ndryshuar	Prishur e kthyer për rigjykim	Mospranim ankimi	
78	1	3	22	
Sasia 104				-
<b>Totali 104</b>				

Gjatë vitit 2023, GJKKO ka shqyrtuar kërkesat me objekt konfiskim pasurie, sipas parashikimeve të Aktit Normativ Nr.1, datë 31.01.2020 “Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit dhe sigurisë publike” të mbartura nga vitet e mëparshme.

Vlen të përmendim se kërkesat e mësipërme, për shkak të kompleksitetit në shqyrtimin e tyre, kanë zgjatur në kohë si çështje, kjo pasi nga gjykata në funksion të barrës së provës, në kuadër të një gjykimi sa më të drejtë e objektiv, janë thirrur ekspertë vlerësues të pasurive të paluajtshme dhe ekspertë kontabël të autorizuar për të vlerësuar pasuritë objekt konfiskimi, janë thirrur dëshmitarë, si dhe janë marrë të gjitha provat e kërkuara nga palët. Si pasojë, gjykimet e kësaj natyre kanë zgjatur në kohë.

<b>Kërkesa për sekuestrim dhe konfiskim pasurie sipas aktit normativ të ankimuara</b>				
<b>Përfunduar në gjykatën e Apelit</b>				<b>Aktualisht në Apel</b>
Lënie në fuqi	Ndryshuar	Prishur e kthyer për rigjykim	Mospranim ankimi	
10	-	1	1	
Sasia 12				1
<b>Totali 13</b>				

**Kërkesa për sekuestrim dhe konfiskim pasurie sipas ligjit antimafia të ankimuar**

<b>Përfunduar në gjykatën e Apelit</b>				<b>Aktualisht në Apel</b>
Lënie në fuqi	Ndryshuar	Prishur e kthyer për rigjykim	Mospranim ankimi	
7	-	-	3	2
Sasia 10				
<b>Totali 12</b>				

**Masa Sigurimi të ankimuar**

<b>Përfunduar në gjykatën e Apelit</b>			<b>Aktualisht në Apel</b>
Lënie në fuqi	Ndryshuar	Mospranim ankimi	
47	7	7	-
Sasia 61			
<b>Totali 61</b>			

### 3. PARAQITJE DHE ANALIZË E TREGUESËVE STATISTIKORË NË VITE

#### 1. Ngarkesa e çështjeve

Ngarkesa e Gjyqtareve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për çështje të gjykuara si kryesues e anëtare në trup gjykues.

Gjyqtar / e	Çështje të gjykuara	Penale		Kërkesa Penale
		<i>I vetëm dhe kryesues</i>	<i>Trup Gjykues</i>	
Irena Gjoka	391	7	14	370
Flora Hajredinaj	252	8	14	230
Etleva Deda	272	10	5	257
Erjon Çela	439	11	17	411
Erjon Bani	344	8	11	325
Atalanta Zeqiraj	540	11	18	511
Flojera Davidhi	310	13	21	276
Rudina Palloj	215	9	26	180
Elsa Ulliri	156	9	13	134
Diamela Goxhaj (e deleguar)	8	1	-	7
Artan Çupi (i deleguar)	3	1	1	1
Petrit Çomo (i deleguar)	1	-	1	-
Esmeralda Xhili (e deleguar)	3	-	3	-
Besmir Stroka (i deleguar)	1	-	1	-
Adelajda Gjuzi (e deleguar)	1	-	1	-
Rexhep Bekteshi (i deleguar)	1	-	1	-
Taulant Banushi (i deleguar)	1	-	1	-
Migena Laska (e deleguar)	1	-	-	1
Aurel Arapi (i deleguar)	5	-	-	5
Edvan Veçani (i deleguar)	1	-	-	1
Paulin Çera (i deleguar)	3	-	-	3
Artan Jahollari (i deleguar)	1	-	-	1
<b>TOTAL</b>	<b>2949</b>	<b>88</b>	<b>148</b>	<b>2713</b>

## 2. Tërësia e çështjeve të trajtuara në vitet 2004-2019

Nëpërmjet kësaj tablele paraqesim të dhënat për treguesit e ngarkesës në vite që nga krijimi i gjykatës për të kuptuar dhe mënyrën e evoluimit të natyrës së çështjeve penale në kompetencën e gjykatës sonë, si dhe për të pasqyruar ngarkesën e gjykatës.

**Tabela: Tërësia e çështjeve të trajtuara në vitet 2004-2019 nga ish Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda**

Tërësia e çështjeve të trajtuara në vite																
Në vite	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Çështje Gjyqësore	140	141	123	124	145	136	111	118	130	171	221	234	211	190	183	142
Masa sigurimi	237	257	266	266	277	181	354	217	312	332	584	535	451	446	198	173
Kërkesa të tjera	96	294	587	550	577	656	926	661	782	901	1432	1473	1333	1755	1749	1591
Sekuestro Konfiskim		14	41	27	22	18	22	17	21	13	31	35	35	33	27	20
Seanca paraprake														49	138	134
<b>Total</b>	<b>473</b>	<b>706</b>	<b>1008</b>	<b>967</b>	<b>1021</b>	<b>991</b>	<b>1413</b>	<b>1013</b>	<b>1245</b>	<b>1417</b>	<b>2268</b>	<b>2277</b>	<b>2030</b>	<b>2473</b>	<b>2295</b>	<b>2060</b>

**Tabela: Tërësia e çështjeve të trajtuara në vitet 2020-2023 nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar**

Tërësia e çështjeve të trajtuara në vitet 2020 - 2023				
Viti	2020	2021	2022	2023
Çështje Gjyqësore	96	149	139	134
Masa sigurimi	126	106	96	140
Kërkesa të tjera	1541	1737	1745	2443
Sekuestro Konfiskim sipas Ligjit Antimafia	30	43	35	49
Seanca paraprake	102	127	153	129
Sekuestro konfiskime sipas Aktit Normativ nr.1, viti 2020	240	199	72	32
<b>Total</b>	<b>2135</b>	<b>2361</b>	<b>2240</b>	<b>2927</b>

Siç rezulton nga përmbajtja e tabelave më sipër, volumi i punës të çështjeve të shqyrtuara në vitin 2023 në total 2927 të tilla, krahasuar me vitet 2020, 2021 dhe 2022 ka pësuar një rritje, e konkretisht 37 % krahasuar me vitin 2020, 24% krahasuar me vitin 2021 dhe 31 % krahasuar me vitin 2022.

Ndërsa për vitin 2023 vërehet se ka një rritje të kërkesave që i përkasin fazës së hetimit paraprak (lejim përgjimi, masa sigurimi), pra 742 më shumë sesa nga viti paraardhës.

### **3. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka dhënë gjithsej 4 vendime Konfiskimi dhe 9 vendime sekuestro në kuadër të Ligjit Antimafia në vitin 2023**

#### **ASETE TE SEKUESTRUARA**

##### **AUTOMJETE:**

- Automjet i markës Nisan
- Automjet i markës Fiat
- Automjet i markës Audi
- Automjet i markës Ford Galaxy
- Automjet i markës Volkswagen
- Automjet i markës Daimler Benz
- Automjet i markës Land Rover
- Automjet i markës Ford
- Automjet i markës Volvo
- Automjeti i markës Smart
- Automjet i markës Land Rover
- Automjet i markës Merced Benz
- Automjet i markës Fiat
- Automjet i markës BMW
- Automjet i markës Volkswagen golf
- Automjet i markës Audi Q8
- Automjet i markës Audi A8
- Automjet i markës Volkswagen golf
- Gomone e markës Yamaha 350
- Gomone tip RAtox
- Gomone tip Suzuki
- Gomone tip Suzuki "G-Rs"
- Automjet i markës Audi
- Automjet i markës "BMW"
- Automjeti tip Audi SQ7, me targa gjermane LR-xxxx
- Automjeti autoveture, marka AUDI, tipi Q7,
- Pasuria e luajtshme mjetin motorik të markës Dayang

##### **APARTAMENTE:**

- Apartament me sipërfaqe 108 m2
- Apartament me sipërfaqe 105 m2
- Apartament me sipërfaqe 38.8 m2
- Apartament me sipërfaqe 81.2 m2
- Garazhd me sipërfaqe 50.82 m2
- Apartament me sipërfaqe 89 m2
- Apartament me sipërfaqe 35.09 m2

- Bodrum me sipërfaqe 9 m2
- Apartament me sipërfaqe 30 m2
- Një garazhd
- Apartament me sipërfaqe 105 m2
- Apartament me sipërfaqe 105 m2
- -Apartament me sipërfaqe 97.8 m2
- -Apartament me sipërfaqe 97.8 m2
- Apartament me sipërfaqe 97.8 m2
- Apartament me sipërfaqe 97.8 m2
- Apartament me sipërfaqe 98.3 m2
- Apartament me sipërfaqe 98.3 m2
- Apartament me sipërfaqe 95.8 m2
- Apartament me sipërfaqe 95.8 m2
- Apartament me sipërfaqe 97.8 m2
- Apartament me sipërfaqe 154.5 m2
- Garazhd me sipërfaqe 12 m2
- Garazhd me sipërfaqe 12 m2
- Garazhd me sipërfaqe 12.5 m2
- Apartament me sipërfaqe 94.8 m2
- Apartament me sipërfaqe 59.5 m2
- Apartament me sipërfaqe 102 m2
- Apartament me sipërfaqe 102 m2
- Apartament me sipërfaqe 133 m2
- Apartament me sipërfaqe 130 m2
- Pasuria e paluajtshme Apartament me sipërfaqe 50.3 m2
- Pasuria e paluajtshme Apartament me sipërfaqe 45.2 m2
- Pasuria e paluajtshme Apartament me sipërfaqe 40.2 m2,
- Pasuria e llojit apartament me sipërfaqe 220.80 m2
- Pasuria e llojit apartament me sipërfaqe 216.50 m2
- Pasuria e llojit apartament me sipërfaqe 47.50 m2
- Pasuria e llojit apartament me sipërfaqe 44.30 m2
- Pasuria e llojit apartament me sipërfaqe 48 m2
- Pasuria e llojit apartament me sipërfaqe 58.70 m2
- Pasuria e llojit apartament me sipërfaqe 46.30 m2
- Pasuria e llojit apartament me sipërfaqe 93 m2

## **TROJE**

- Toke Are me sipërfaqe 3250 m2
- Toke are me sipërfaqe 6026 m2
- Toke are me sipërfaqe 3250 m2
- Toke are me sipërfaqe 3250 m2
- Toke pyll me sipërfaqe 6026 m2
- Pasuria me sipërfaqe 82 m2

- Pasuria me sipërfaqe 245 m2
- Pasuria e lloji njësi me sipërfaqe 137 m2
- Ullishte me sipërfaqe 9800 m2
- Toke are me sipërfaqe 3815 m2
- Toke are me sipërfaqe 7000 m2
- Toke are me sipërfaqe 12145 m2
- Toke are me sipërfaqe 1973 m2
- Toke are me sipërfaqe 7050 m2
- Truall me sipërfaqe 1975 m2
- Toke are me sipërfaqe 1632 m2
- Toke truall me sipërfaqe 300 m2
- Toke are me sipërfaqe 2543 m2
- Toke are me sipërfaqe 410 m2
- Toke are me sipërfaqe 120 m2
- Pasuri e llojit truall + ndertese me sipërfaqe 580 m2
- Toke truall me sipërfaqe 300 m2
- Toke truall me sipërfaqe 5200 m2
- Pasuria, me sipërfaqe 1000 m2, e llojit "ullishte"

#### **SHUMA MONETARE**

- Shuma prej 45.000 euro
- Shuma prej 500 paund
- Shuma prej 50 franga zvicerane
- Shuma prej 2.344.500 leke
- -Shuma prej 190.013.78 euro
- -Shuma prej 68.987.00 euro
- 27 Llogari bankare

#### **KUOTA TE SHOQERIVE TREGTARE**

- 100% Kuotat e Shoqërisë “Zeus Garden shpk”
- 49% te kuotave te Shoqërisë “MSG Security “shpk
- 100% Kuotat e Shoqërisë “KK Sha”
- 50 % kuotat e Shoqërisë “AT shpk”
- 100% Kuotat e Shoqërisë “MU” Sha
- 100% Kuotat e Shoqërisë”
- Subjekti “E.M FF
- 100% Kuotat e Shoqërisë “RF shpk”
- Subjekti “D.M”
- Subjekti “V.K”
- 100% Kuotat e Shoqërisë “S.P.E”
- 21 % te Kuotave të Shoqërisë “S.P.E”
- 100% Kuotat e Shoqërisë “R...”
- 100% Kuotat e Shoqërisë “L...”



- 25% te aksioneve te Operatorit Ekonomik "G. L.....shpk
- 50% te aksioneve te Operatorit Ekonomik "K....." shpk
- 50% te aksioneve te Operatori Ekonomik "R....." shpk

### **ASETET E KONFISKUARA:**

#### **1. AUTOMJETE:**

- Automjet i tip "Volkswagen Golf me targe AAxxx
- Automjet i tip "Furgon", i markes Iveco, me targa AAxxxx
- Automjeti i tip "Mercedes Benz" me targe AAxx
- Automjet, tip furgon i markes "ATP" Daimler Chrysler me targe AAxx
- Automjeti tip BMW me targa AAxxx
- Automjeti tip BMW me targa AAxxx
- Automjet tip Audi me targa AA xxx
- Automjet tip Mercedes Benz MI270
- Automjet tip Mercedes Benz 300D
- Automjeti tip Daimler Chrysler S500
- Automjeti tip Audi A8
- Automjeti tip Mercedes Benz S63 AMG
- Automjet i markes BMW
- Automjet i markes BMW
- Motor i markës Yamaha
- Automjet tip Mercedes Benz , me targe Axxxx
- Automjet tip Range Rover, me targe Axxxx
- Automjet tip Audi A2, me targe Axxx
- Automjet tip Mercedes Benz, me targe Axxxx
- Automjet tip Mercedes Benz me targe Axxx

#### **2. APARTAMENTE**

- Apartamenti nr.1, kati 7 me sip. 114.27 m2
- Pasuria e llojit apartament, me sipërfaqe 33.47 m2,

#### **3. TROJE**

- Sipërfaqja 65 m2 së bashku me katin sipër saj me sipërfaqe ndërtimi 70.61 m2
- Sipërfaqja 65 m2 së bashku me katin sipër saj me sipërfaqe ndërtimi 71.02 m2
- Sipërfaqja 65 m2 së bashku me katin sipër saj me sipërfaqe ndërtimi 67.84 m2
- Sipërfaqja 64 m2 së bashku me katin sipër saj me sipërfaqe ndërtimi 73.20 m2
- Sipërfaqja 65 m2 së bashku me katin sipër saj me sipërfaqe ndërtimi 73.20 m2
- Toke Truall me sipërfaqe 3.289 m2
- Toke truall me sipërfaqe 14000 m2
- Toke Are me sipërfaqe 1467 m2
- Ullishte me sipërfaqe 2183 m2

#### **4. KUOTA TË SHOQËRIVE**

- Kuotat 100% të personit juridik “R... 2015” shpk
- 100% Kuotat e Shoqërisë “P....”
- 33% e kuotave të Shoqërisë “A... shpk”

#### **5. VLERA MONETARE**

- Shuma monetare prej 15.000 euro
- Shuma monetare prej 173.500 euro
- Shuma monetare prej 8.629.000 lekë
- Shuma monetare prej 1.981.946 lekë
- Shuma monetare prej 1.121.298 lekë
- Shuma monetare prej 2.022 euro
- Shuma monetare prej 19.000 euro

## V. KRYESEKRETARIA.

Kompetencat e Kryesekretarisë dhe sekretarisë gjyqësore parashikohen shprehimisht në nenin 43-44 të ligjit nr. 98/2016 *“Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar. Kryesekretari ka në kompetencë bashkërendimin, organizimin dhe ndarjen e punës së zyrës së sekretarisë nën drejtimin e kancelarit të gjykatës. Kryesekretari ushtron kompetencat e mëposhtme: a) lëshon vërtetime për të dhënat e kërkuara nga palët nga regjistrat në gjykatë; b) nënshkruan të gjitha aktet procedurale që kërkojnë njoftime procedurale, siç janë: i) vendimet gjyqësore që bëhen përfundimtare; ii) vendime përfundimtare dhe të ndërmjetme që dërgohen për ekzekutim; iii) ekstrakte dhe fotokopje të njësuara me origjinalin të akteve të gjykatës; iv) të gjitha aktet e tjera të nxjerra nga gjykata, krahas nënshkrimit të personit që i ka përgatitur; c) çdo detyrë tjetër e përcaktuar me ligj.

Kryesekretaria ka përballuar një ngarkesë të madhe pune, gjë që vërehet nga numrat në rritje të çështjeve/kërkesave penale të regjistruara e të gjykuara gjatë këtij viti, duke filluar që nga përgjimet, masat e sigurimit e në vijim.

Nga stafi i kryesekretarisë vazhdon të ofrohet shërbim gjatë orarit zyrtar 08.00-16.00. Në zyrën e Kryesekretarisë ofrohen shumë shërbime, të tilla si: regjistrimi i kërkesave të ardhura nga palët dhe prokuroria, për të cilat kryhet verifikim paraprak, kryerja e veprimeve të komunikimeve të vendimeve, ankimeve, masave, IT, ftuesve etj. Gjatë vitit 2023 janë trajtuar dhe u është kthyer përgjigje, një numri të madh shkresash, të tilla si: kërkesa nga institucionet e ndryshme, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Gjykatave dhe Prokurorive të rretheve, Komisariateve të Policisë, Zyrrave të Përmbarrimit, Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, Zyrrave Vendore të Shërbimit të Provës, kërkesa e ankesa nga qytetarët, shkresa për dërgim vendimesh e kthim aktesh prokurorisë, dërgim vendimesh Ministrisë së Drejtësisë, etj.

Me ndryshimet e reja që pësoi Kodi i Procedurës Penale në vitin 2021, ku parashikohet njoftimi i vendimit të arsyetuar palëve në proces, është rritur ndjeshëm volumi i punës në sekretarinë gjyqësore. Kjo ngarkesë shpjegohet si rezultat i faktit se, vendimet e GJKKO-së në tërësinë e tyre janë voluminoze, si pasojë të specifikës që ato kanë, qoftë lidhur me numrin e lartë të të pandehurve, apo numrin e madh të akuzave për të cilat janë hetuar dhe gjykuar këta të pandehur. E njëjta gjë vlen edhe për masat e sigurimit, gjë që krijon një volum të madh pune për punonjësit e administratës gjyqësore, si dhe passjell rritje të kostos së shpenzimeve të gjykatës për njoftimin e akteve palëve në proces. Një problematikë e hasur në këtë aspekt, është njoftimi i të pandehurve të gjykuar në mungesë, veçanërisht në rastin kur adresat e vendosura në dispozicion nuk janë të sakta e të plota dhe bëjnë të pamundur apo vështirësojnë realizimin e njoftimit nga ana e shërbimit postar.

## 1. Infrastruktura e zhvillimit të gjykimeve në GJKKO.

Në GJKKO ndodhen gjithsej 5 (pesë) salla gjykimi, te cilat janë të pajisura me sistem regjistrimi audio, ndërkohë që salla 1 është e pajisur edhe me sistem video regjistrimi.

Më poshtë paraqitet tabela me numrin e seancave audio të zhvilluara, për çdo gjyqtar, për vitin 2023.

### 1.1 Përdorimi i sistemit Audio.

Paraqitja në përqindje e numrit të seancave gjyqësore, që regjistrohen në sistemin audio dhe shkaqeve, për të cilat procesverbalet mbahen me mjete të tjera (kompjuter apo dorëshkrim).

**Tabela: Përdorimi i sistemit të regjistrimit audio në periudhën 10.01.2023 – 31.12.2023**  
**Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar**

Nr	Gjyqtari	Seanca të regjistruar a audio	Seanca të paregjistruara audio	Gjithsej (Total)	Në % (Sasi / Total)
1	Irena GJOKA	287	399	686	42%
2	Flora HAJREDINAJ	404	203	607	67%
3	Etleva DEDA	291	286	577	50%
4	Erjon ÇELA	399	364	763	52%
5	Erjon BANI	277	221	498	56%
6	Atalanta ZEQIRAJ	255	215	470	54%
7	Flojera DAVIDHI	174	29	203	86%
8	Elsa ULLIRI	181	56	237	76%
9	Rudina PALLOJ	183	160	343	53%
10	Albert MEÇA (i deleguar)	4	0	4	100%
11	Artan ÇUPI (i deleguar)	8	1	9	89%
12	Artan JAHOLLARI (i deleguar)	5	0	5	100%
13	Aurel ARAPI (i deleguar)	19	0	19	100%
14	Diamela GOXHA (e deleguar)	31	1	32	97%
15	Edvan VEÇANI (i deleguar)	2	1	3	67%
16	Esmeralda XHILI (e deleguar)	10	1	11	91%
17	Migena LASKA (e deleguar)	11	1	12	92%
18	Paulin ÇERA (i deleguar)	30	4	34	88%
	Totali	2571	1942	4513	57%

Vlen për t'u theksuar fakti se seancat gjyqësore që i përkasin çështjeve të themelit, seancave paraprake, kërkesat penale, kërkesave për sekuestrim e konfiskim sipas Ligjit Antimafia dhe Aktit Normativ, masave të sigurimit regjistrohen nëpërmjet sistemit audio. Seancat, të cilat nuk regjistrohen në sistemin audio pranë GJKKO-së, i përkasin kryesisht kërkesave për lejim/vleftësim/autorizim/zgjatje përgjimi, kërkesave me objekt ekzekutim letërporosie, si dhe kërkesave për caktim mase sigurimi në mungesë. Kjo, për shkak të ruajtjes së sekretit hetimor. Në këtë kontekst, theksojmë faktin se kjo është arsyeja që regjistrimi i të gjitha seancave audio nuk është në masën 100%.

## VI. DREJTORIA E BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

**Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar** e GJKKO-së përbëhet nga Drejtori i Drejtorisë dhe specialistja e financës. Detyrat e këtij sektori janë të përcaktuara shprehimisht në nenin 41/b, të Ligjit nr. 98, datë 06.10.2016 *“Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, ku sipas nenit 45 të ligjit të sipërcituar, parashikohet se “Shërbimi financiar ushtron dhe zbaton detyrimet që rrjedhin nga Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, *“Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, Ligji 10296, datë 08.07.2010, *“Për menaxhimin dhe kontrollin financiar”*, i ndryshuar, në aktet në zbatim të tyre si dhe në Vendimin e KLGJ nr. 148 datë 29.03.2023 *“Për miratimin e rregullave standarte për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, kategoria e parë, me zyrë shërbimi”*. Kjo Drejtori është përgjegjëse për hartimin e Raportit Financiar për vitin 2023.


### Raporti Financiar për Vitin 2023

Më poshtë paraqiten disa nga treguesit kryesorë të realizimit të planit buxhetor për vitin 2023.

Plani i buxhetit me gjithë ndryshimet që ka pësuar gjatë vitit raportues paraqitet i realizuar si në tabelën e mëposhtme, i detajuar me artikujt përkatës dhe i shprehur në përqindje dhe në vlerë absolute :

Artikulli	Emërtimi	Plani vjetor 2023 i rishikuar	Fakti i realizimit të planit 2023	Realizimi në përqindje	Diferenca e planit në vlerë
231	Investime	8,400,000	7,820,546	93.1	579,454
600	Paga dhe shpërblime personel	177,937,500	173,869,980	97.7	4,067,520
601	Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	14,600,000	13,766,754	94.3	833,246
602	Shpenzime operative	23,530,000	21,209,988	90.1	2,320,012
606	Ndihma ekonomike	288,400	288,400	100	-
<b>Total</b>		<b>224,755,900</b>	<b>216,955,668</b>	<b>96.5</b>	<b>7,800,232</b>

Më poshtë paraqitet grafikisht pesha specifike që zënë artikujt e buxhetit në realizimin faktik të tij për vitin 2023:



**1. Artikulli 600 & 601 (Paga dhe sigurime).** Plani për periudhën 12-mujore ka pësuar ndryshime, duke u shtuar gjatë vitit 2023, në total në masën +67,397,500 lekë ose 48.87% të planit fillestar dhe në Artikullin 600 : dhe +2,600,000 ose 18.3.% të planit fillestar të Artikullit 601.

Në zbatim të Vendimit nr. 351, datë 27.02.2022, të KLGJ-së “Mbi zbatimin të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, të Vendimit nr. 476, datë 13.09.2023 të KLGJ-së “Mbi shpërndarjen e fondeve buxhetore për vitin 2023”, të VKM së nr. 755, datë 20.12.2023 , “Për një shtesë në buxhetin e miratuar për vitin 2023 për disa institucione të pavarura të krijuara me ligj”, me shtesat e bëra si më lart, nga ana e institucionit tonë u bë i mundur likuidimi i detyrimeve të prapambetura të pagave të gjyqtareve të kësaj gjykate.

Vijon puna gjatë vitit 2024 për likuidimin e detyrimeve për sigurime shoqërore dhe shëndetësore të lindura si rezultat i rideklarimit të periudhave të mëparshme kohore.

Realizimi i këtij zëri në fund të vitit, me ndryshimet e pësuar paraqitet në masën 97.45.


Struktura organike mbetet e paplotësuar të (kryesisht me gjyqtarë -7 ) dhe në fund të 12 mujorit, struktura organike paraqitet: Plan 65, fakt 55.

**2. Artikulli 602 (Shpenzime Operative).** Plani për këtë zë ka pësuar ndryshim. Ai paraqitet i shtuar në masën 1,830.000 lekë, për të bërë të mundur ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të krijuar gjatë vitit 2023.

Realizimi i këtij zëri shpenzimesh për periudhën raportuese është në masën 90.1%. Edhe pse me këtë realizim raportojmë se nuk kemi krijuar detyrime të prapambetura në këtë zë.

Në vijim, paraqitet grafiku i përqindjes (%) që zënë zërat e shpenzimeve operative analitike në realizimin faktik total të shpenzimeve operative për vitin 2023.

**Përqindja e zërave operative analitike në realizimin faktik total të shpenzimeve operative për vitin 2023 , artikulli 602 paraqitet si me poshtë.**



Sikurse vihet re nga grafiku i mësipërm, pjesën kryesore të shpenzimeve operative në artikullin 602 e zënë **shpenzimet për shërbime** siç janë, ato për energji elektrike, ujë, shpenzime postare, shpenzime telefonike dhe celulare, të cilat zënë **32% të tyre**.

Shpenzimet për pagesë avokatësh, ekspertësh, psikologësh dhe përkthyesish, taksa, tatime, ekzekutim vendimesh gjyqësore etj., paraqiten në masën 19% të tyre.

**Shpenzimet për blerje materiale të ndryshme** si: letër, kancelari materiale pastrimi, lëndë djegëse kaldaje, gjenerator, abonime, etj., paraqiten në masën **23% e tyre**.

**Shpenzimet e transportit** për blerje pjesë këmbimi, goma, bateri dhe mirëmbajtje mjete transporti, paraqiten në masën 17%.

**Shpenzimet e mirëmbajtjes së zakonshme** për godinën, sistemin e ngrohjes dhe të ftohjes, mirëmbajtje elektrike teknike dhe elektronike, zënë 9 % të shpenzimeve faktike vjetore.

Prokurimet e realizuara për shpenzime operative janë të pasqyruara hollësisht dhe të detajuara si në tabelë.



**Tabela: Prokurimet e realizuara për shpenzime operative**

Nr.	Emertimi	Fondi limit	Vlera e kontratës me tvsh	Operatori ekonomik fitues	Periudha e zhvillimit
1	Blerje bileta transporti ajror ndërkombëtar	34240	34240	EXPLORER TRAVEL	16/10/
2	Tonera	49800	59760	INFOSOFT OFFICE	19/12/
3	Abonime (fletore zyrtare ,libra publikime)	46280	46280	QB Zyrtare, Posta	17/01/ 22/02/
4		218500	238080	ANI-print,FLESH	09/02/,11/10/
5	Uniforma (Pelerina)	68200	81840	Gentian Sadiku	28/12/
6	Leter A4, A3 Kancelari	995257	1194308	OFFICE Center, InfoSoft Office, E Qafmolla Librari Durrahu	05/04/; 25/01/; 25/05/
7	Materiale Pastrimi ,dezinfektimi anticovid,	287000	344400	Besim Kamberi,HEP 2012	27/07/,19/12/
8	Furnizime me materiale te tjera te pergjithshme	100000	120000	S Rrokaj, V Osmani, DPPolicise Shtetit	04/03/; 19/05/,16/06/; 19/07/
9	Blerje karburanti /vaji	3330761	3996537	2A2F-L Oil , A &T SHA	16/05/,25/04/
10	Pjese Këmbimi Goma,Bateri	100000	120000	TETEA, T Kurti, BENNETT	19/04/; 25/05/; 03/08/
11	Sherbime te tjera transporti(Lavazh Automjetesh)	269400	285640	Xhovan Gjini, MARA INT&SERVICES	01/02/, 16/06/
12	Sherbime te printimit dhe publikimit	996500	1195800	AICOM	28/02/,17/11
13	Mirembajtje Pajisje elektronike				
14	Sherbim Mirembajtje mjete transporti / riparime	607789	720666	CLASSIC,Compitel, O&A, Besnik Meci, Telia Kurti, Tetea, Erblina Beqiri	13/03,06/02, 27/7,5/5,19/6, 15/06/,14/12/, 25/05/,19/12/, 12/04/,20/10/,03/11, 22/05/,10/11,23/11
15	Sherbim i siguracioneve të mjeteve të transportit	396805	396805	INSIG SHA	20/02,25/05
16	Mirembajtje rrjeteve hidraulike ,elektrike , teknike (Ashensore, kaldaje siguri, gjenerator, telefon, qender zeri,Mkz)	782290	938748	T & P SHPK CLAS ASH, EKM KONST,	15/03/,20/12,19/10/, 17/03/,15/12,01/11/
17	Mirembajtje lulishte	100000	120000	T Kurti V Osmani E Beqiri	27/12/, 22/12/
18	Mirembajtje Godine (Lyerje, riparim dyer dritare pllaka)	277200	332640	T Kurti,EKM KONSTR, H Xhagolli,O&A,Murati BA	13/03/,13/12, 22/05/,09/10/
19	Te tjera materiale dhe sherbime speciale (te personalizuara)	90000	108000	Optima Communion	17/05/
20	Blerje inventari i imet	99500	119400	V Gjoshe V Osmani	22/05/, 18/12/
21	Mirembajtje faqe WEB	298000	357600	ARK IT	29/06/
22	Shpenzime për pritje përcjellje Institucioni	59320	71184	Vjollca Osmani V Gjoshe	26/04/
23	Sherbim per deratizimin, dezinfektimin dhe dezinfektimin ne ambientet e Arkives	75000	90000	ALPEST	15/12/
	<b>Totali</b>	<b>9281842</b>	<b>10971928</b>		

**3. Artikulli. 606,** pasqyron fondet e çelura nga fondi i veçantë dhe të miratuara nga KLGJ-ja në masën 288,400 lekë; dhe është përdorur për dhënie ndihmë ekonomike në tre raste për punonjëse me sëmundje të rënda dhe kronike, një rast për një punonjës të dalë në pension pleqërie dhe një rast për një punonjës për fatkeqësi në familje.

**4. Artikulli 231 (Investime).** Plani në këtë zë shpenzimesh nuk ka pësuar ndryshime nga ai i akorduar në fillim të vitit 2023, dhe është realizuar në masën 93.1%. Pjesa e parealizuar paraqet kryesisht fondet e lira të krijuara nga procesi i prokurimeve elektronike.

Projektet e realizuara në këtë zë do të shërbejnë për rritjen e sigurisë së institucionit si një institucion i një rëndësie të veçantë, rritjes së sigurisë dhe cilësisë së ruajtjes së dokumentacionit të sektorit të arkivës, etj.

Në këtë zë shpenzimesh janë realizuar disa projekte sipas tabelës së mëposhtme të realizimit të regjistrit të prokurimeve për vitin 2023.

**Tabela: Projekte të realizuara në zërin e shpenzimit “Investime”**

Nr.	Emertimi	Fondi Limit	Vlera e kontratës me tvsh	Operatori ekonomik fitues	Periudha e zhvillimit viti 2023
1	Bateri për inverter Qendror	538890	646668	SINTEZA CO	06/12/
2	Blerje Paisje Sigurie per Arkive ( Sistem shuaje zjarri,Sistem dedektim lageshti temperature zjarr,Dyer te blinduara me brava automatike)	4075000	4890000	CSP	24/10/
3	Blerje makina grirëse	142000	170000	EURO OFFICE	20/12/
4	Blerje Paisje (Kondicionere)	249300	299160	Bledi Loci	02/10,18/12/
5	Rafte metalike me inkastrim	425000	510000	FRAL 2000	13/10/
6	Pompë grirëse e ujrave të zeza	221000	265200	Ajet Cemalli	26/05/
7	Paisje te tjera Barriere bllokuese me telekomandim	85067	102080	EKM Konstrk&Tekn	
8	Dyer te jashtme hyrese antipanik per godine	425000	509998	Naim Hysi	31/10/
9	Blerje paisje te tjera	356200	427440	COMMUNICATION PROG	20/12/
	<b>Totali</b>	<b>6517457</b>	<b>7820546</b>		

## Tabela: Buxheti i GJKKO për 3 vitet e fundit

Më poshtë po japim një pasqyrë krahasuese të shpenzimeve operative për tre vitet e fundit:

Nr.	Emërtimi i zërave buxhetore	2021			2022			2023		
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
1	Investime	6,870,000	5541600	81	4,342,000	4342000	100	8,400,000	7,820,546	93
2	Paga Sherbime personeli	83,000,000	80397650	97	96,000,000	93536091	97	177,937,500	173,869,980	98
3	Kontribute te sigurimeve shendetesore dhe shendetesore	10,000,000	8656078	87	9,750,000	9746486	100	14,600,000	13,766,754	94
4	Mallra dhe sherbime te tjera	18,520,000	15624518	84	17,400,000	17399573	100	23530000	21209988	90
4.1	Materiale dhe sherbime zyre	3,668,000	2586242	71	3,537,000	3354184	95	5210000	4909286	94
4.2	Sherbime	5,962,000	6277400	105	6,100,000	6457489	106	8080000	6804980	84
4.3	Shpenzime transporti	3,440,000	2327636	68	3,683,000	3408034	93	3380000	3614762	107
4.4	Shpenzime udhetimi	50,000	1000	2	200,000	552170	276	360000	72153	20
4.5	Shpenzime mirembajtje te zakonshme	2,008,000	1438482	72	1,980,000	1462580	74	1780000	1868188	105
4.6	Shpenzime te tjera operative	3,392,000	2993758	88	1,900,000	2165116	114	4720000	3940619	83
5	Transferta per buxhete familjare	568,500	88500	16	820,800.00	820,800	100	288,400	288,400	100
	<b>Totali</b>	<b>118,958,500</b>	<b>110,308,346</b>	<b>93</b>	<b>128,312,800</b>	<b>125,844,950</b>	<b>98</b>	<b>224,755,900</b>	<b>216,955,668</b>	<b>97</b>

Nga tabela e mësipërme vihet re rritja e shpenzimeve buxhetore për vitin 2023 në masën 72.3% më shumë krahasuar me vitin 2022. Kryesisht vërehet rritja në zërat e shpenzimeve të personelit për arsyen që u trajtua më sipër. Kurse për rritjen e shpenzimeve në zërat e tjerë të artikujve buxhetore, raportojmë se ato kanë ardhur për shkak të rritjes së numrit të çështjeve gjyqësore të realizuara (Plan 2500 ; fakt 2796), rritjen e çmimeve të mallrave të prokuruar, rritjen e nevojave për mirëmbajtje të zakonshme, mirëmbajtje godine, mirëmbajtje automjetesh, për shkak të amortizimit të tyre, por dhe rritjen e nevojave për investime të reja.

**Të ardhura** të realizuara nga institucioni nga shitja e fotokopjeve dhe pullave të taksës për dhënie e vendimeve gjyqësore për vitin 2023 paraqiten të detajuara në pasqyrën e mëposhtme. Këto të ardhura janë derdhur plotësisht në buxhetin e shtetit.

## Tabela: Të ardhura të realizuara nga institucioni për vitin 2023

Artikulli	Emertimi	12- MUJORI 2023
7081006	Taksa e Akteve dhe të Pullës (10% i të ardhurave nga pullat)	10400
7115401	Gjoha gjyqësore	0
7111008	Të ardhura nga fotokopja	299830
	<i>Shuma e kl.7</i>	<i>310230</i>
4665100	90% i të ardhurave nga pullat	93600
4665100	90% i të ardhurave nga 1%	0
	<i>Shuma e kl. 4</i>	<i>93600</i>
	<b>TOTALI</b>	<b>403830</b>

**Tabela: Të ardhurat për vitet 2021-2023**

<b>Të ardhura dytësore që kalojnë nëpërmjet degës të thesarit</b>				
<b>Artikulli</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>2021</b>	<b>2022</b>	<b>2023</b>
	Taksa e Akteve dhe e Pullës (10% i te ardhura nga pullat)	12000	13420	10400
Klasa 7	Gjoha gjyqësore	20,000	163470	0
	Te ardhura nga fotokopja	606870	529930	299830
	<b>Shuma e kl.7</b>	<b>638870</b>	<b>706820</b>	<b>310230</b>
Klasa 4	90% i të ardhurave nga pullat	108000	120780	93600
	<b>Shuma e kl 4</b>	<b>108000</b>	<b>120780</b>	<b>93600</b>
<b>TOTALI (Klasa 7 dhe 4)</b>		<b>746870</b>	<b>827600</b>	<b>403830</b>

Gjatë vitit 2023 të ardhurat e mbledhura janë me të reduktuara krahasuar me vitet paraardhëse pasi siç shihet ne tabelë nuk kemi gjoha gjyqësore të arkëtuara nga përmbarimi por dhe një rënie e kërkesës për fotokopje aktesh.

Gjatë vitit raportues GJKKO-ja nuk ka qenë objekt auditimi pasi është ushtruar auditim gjatë viteve 2021 nga Auditi i Brendshëm i KLGJ-së dhe gjatë vitit 2022 nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ku është vlerësuar **pozitivisht** veprimtaria ekonomike financiare e institucionit, por janë lënë dhe rekomandime për përmirësimin e punës në këtë aspekt të cilat janë zbatuar dhe janë duke e zbatuar në vijim.

## **VII. SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE, SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE DHE PROKURIMEVE**

Risia e këtij viti që analizojmë për sistemin gjyqësor është hyrja në fuqi e vendimit të KLGJ-së me nr. 147, datë 29.03.2023 *“Për përcaktimin e kategorive të gjykatave”*, ku Gjykata e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar u kategorizua si **“Kategoria e parë (e lartë)”**. Në zbatim të Vendimit të KLGJ-së nr. 148, datë 29.03.2023 *“Për miratimin e rregullave standarde për organigramën, përshkrimin e detyrave dhe përgjegjësive të pozicioneve të nëpunësve civilë gjyqësorë dhe punonjësve të tjerë të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, kategoria e parë, me zyrë shërbimi”*, si dhe me Vendimin e Këshillit të GJKKO-së nr. 6, datë 07.07.2023 *“Për miratimin e Strukturës dhe Organigramës”*, u përcaktua Struktura dhe Organigrama e re e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

### **Panoramë e përgjithshme e Burimeve Njerëzore për vitin 2023.**

Me Vendimin e Këshillit të GJKKO-së nr. 8, datë 07.07.2023 *“Për Transferimin e përhershëm të nëpunësve civil pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”*, u transferuan specialistët përkatës në Sektorin e Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve.

Gjithashtu gjatë vitit kalendarik u zhvillua edhe procesi për rekrutimin e Shefit të Sektorit, procedurë e cila përfundoi me Vendimin nr. 14, datë 06.11.2023.

### **Përbërja:**

Sektori i Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve është i përbërë nga një Shef Sektori, 3 Specialistë të Shërbimeve Mbështetëse, 1 Mirëmbajtës, 1 Punonjës Sigurie, 4 Nëpunës gjyqësor, 1 Nëpunës gjyqësor/Ftues, 5 Shofer, 3 Sanitare dhe ka vakancë pozicionin e “Specialistë Burimesh Njerëzore” dhe “Specialist Prokurimesh Publike”.

### **Rekrutime për vitin 2023:**

- 1 pozicion i nivelit të mesëm drejtues,
- 3 pozicione të nivelit të ulët drejtues,
- 3 pozicione të nivelit ekzekutiv,
- 1 pozicion pa kandidat fitues.

Numri i pozicioneve të shpallura vakante për vitin 2023 pranë GJKKO-së kanë qenë 8 nga të cilat janë rekrutuar 7 punonjës në shërbimin civil gjyqësorë, tre prej të cilëve me procedurën e ngritjes në detyrë, tre me lëvizje paralele dhe një punonjës me pranim nga shërbimi civil dhe një procedurë e përfunduar pa kandidatë fitues.


Numri i punonjësve të tjerë gjyqësor të emëruar sipas procedurave të Kodit të Punës përgjatë vitit 2023 ka qenë 2 punonjës.

**Konkretisht:**

- Inxhinier elektrik.
- 1 Shofer.

Me Vendimin e Këshillit të Gjykatës Nr.22, datë 29.12.2022, është miratuar dhe ka hyrë në fuqi Rregullorja e Brendshme “Për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Gjyqësore të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, si dhe “Kodi i Etikës së Administratës Gjyqësore të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, akte këto të nxjerra në përputhje me ndryshimet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe me rëndësi të madhe në mbarëvajtjen e veprimtarisë së punës të punonjësve të administratës së GJKKO-së.

**Struktura Organizative e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është e përbërë nga:**



<b>Nr.</b>	<b>Pozicioni sipas organikës</b>	<b>Numri</b>
<b>1</b>	Kryetar	<b>1</b>
<b>2</b>	Zv/Kryetar	<b>1</b>
<b>3</b>	Gjyqtarë	<b>14</b>
<b>4</b>	Kancelar	<b>1</b>
<b>5</b>	Kryesekretare	<b>1</b>
<b>6</b>	Sekretare gjyqësore	<b>18</b>
<b>7</b>	Drejtor i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar	<b>1</b>
<b>8</b>	Specialist finance	<b>1</b>
<b>9</b>	Magaznier	<b>1</b>
<b>10</b>	Shef i Sektorit IT, Statistike dhe MPM	<b>1</b>
<b>11</b>	Specialist IT	<b>1</b>
<b>12</b>	Specialist i Marr. me Publikun, Median dhe Jashtë	<b>1</b>
<b>13</b>	Specialist për statistika gjyqësore	<b>1</b>
<b>14</b>	Shef i Sektorit të B.NJ., SH.M. dhe Prokurimeve	<b>1</b>
<b>15</b>	Specialist Burime Njerëzore/Prokurime	<b>1</b>
<b>16</b>	Nëpunës gjyqësorë	<b>5</b>
<b>17</b>	Specialistë të SSHM	<b>3</b>
<b>18</b>	Punonjës sigurie	<b>1</b>
<b>19</b>	Mirëmbajtës	<b>1</b>
<b>20</b>	Shoferë	<b>5</b>
<b>21</b>	Sanitare	<b>3</b>
<b>22</b>	Shef Sektori Protokoll/Arkivë	<b>1</b>
<b>23</b>	Specialist Protokoll/Arkivë	<b>1</b>
<b>Totali</b>		<b>65</b>

Numri i punonjësve, sipas strukturës organizative të GJKKO-së për vitin 2023, është 65 punonjës, nga të cilët 16 gjyqtarë dhe 49 administratë gjyqësore.

Në dhjetor të vitit 2023, numri total i gjyqtarëve faktik në GJKKO ishte 9 gjyqtarë (nga 16 të përcaktuar).

Për sa i përket numrit faktik të punonjësve të administratës gjyqësore, për GJKKO, në dhjetor të vitit 2023 rezultoi të jenë në total 46 punonjës nga 49 punonjës sipas strukturës organizative.

Gjatë vitit 2023, Këshilli i GJKKO-së ka zhvilluar rreth 23 mbledhje, ku janë miratuar 23 vendime të ndryshme në funksion të mbarëvajtjes së veprimtarisë së gjykatës.

## **Informacion mbi punën e kryer nga Sektori i Burimeve Njerëzore, Shërbimeve Mbështetëse dhe Prokurimeve për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023.**

Gjatë periudhës 01.01.2023 deri 31.12.2023 vëmendja kryesore i është kushtuar kontrollit dhe mirëmbajtjes së sistemit të ngrohjes dhe ftohjes qendrore të godinës së GJKKO, sistemit elektrik, sistemit të ajrimit, funksionimit normal të sistemit të drenazhit, sistemeve hidraulike, sistemit MKZ, si dhe gjendjes teknike të ashensorëve.

Duke qenë se sistemi ngrohje-ftohje funksionon vetëm gjatë orarit zyrtar, 08.00 – 16.00, për punonjësit të cilët për arsye të ngarkesave në punë, janë të detyruar të qëndrojnë jashtë orarit zyrtar, ose për arsye gatishmërie, specialistët e SSHM-së, punojnë edhe në ditët e pushimeve ose të festave zyrtare, për të krijuar kushte të përshtatshme pune.

Për të ruajtur funksionimin normal të sistemit të drenazhit dhe të shkarkimit të ujërave të zeza, për të shmangur përmbytjen e ambienteve në katin -1, nën hollin e publikut ku gjenden magazina, depozitat e ujit sanitar si dhe arshivat me dokumentacionin e Gjykatës së Lartë është bërë montimi i dy pompave të reja grirëse.

Si pasojë e periudhës së gjatë të shërbimit të qepenave në hyrjen e bodrumit të godinës dhe numrit të madh të hapje – mbylljeve gjatë ditës për të ruajtur kushtet e sigurisë në këtë sektor është bërë riparimi i qepenave dhe zëvendësimi i motorëve elektrikë dhe i elementëve metalikë të tyre.

Pjesë përbërëse e sistemeve elektromekanike në ambientet e godinës është edhe sistemi UPS, i cili furnizon me energji elektrike serverat dhe sistemin kompjuterik të godinës, si dhe në rastet e ndërprerjes së energjisë në rrjetin kryesor, shërben për vënien në funksionim të gjeneratorit duke shmangur anomalitë në funksionimin e sistemit kompjuterik dhe të ndriçimit. Për të mbajtur në gatishmëri të plotë këtë pajisje është bërë kontrolli dhe shërbimet periodike të mirëmbajtjes si dhe zëvendësimi i baterive në panelin e tyre, 33 copë bateri 12v100Ah, të cilat për të mbajtur në gjendje pune normale sistemin ndërrohen çdo tre vjet.

Duke qenë se dyert e jashtme “*antipanic*”, në hyrje të godinës së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, holli N0004, si pasojë viteve në shërbim dhe numrit shumë të madh të hyrje – daljeve, ishin të konsumuara dhe nuk mbylleshin normalisht si dhe ishte plasaritur struktura mbajtëse e tyre, u vendosën dyer të reja “*antipanic*”, në hollin kryesor të godinës, N 0004.

Gjithashtu ambientet e zonës së birucave të godinës së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar nuk ishin lyer prej një periudhe të gjatë, si dhe mbështetur në kërkesën e specialistëve të DP Burgjeve), drejtuar Kancelarit të GJKKO u bë lyerja dhe riparimi i suvasë së mureve në disa prej ambienteve të sektorit të birucave si më poshtë:

**B15, B16, B17, B19, B20, B21, B22, B23, B24, B26, B27, B006, B008.**

Gjatë gjithë periudhës janë mbajtur nën kontroll dhe janë riparuar barrierat e sigurisë në të dy anët e godinës së GJKKO.



Për gjatë gjithë vitit është mbajtur nën kontroll të përditshëm, në përputhje me grafikun e kontrollit dhe të shërbimeve sistemi MKZ dhe ashensorët të cilëve u është bërë shërbim profilaktik i përmuajshëm, ndërrimi i kavove, ndërrimi i inverterave, butonave dhe kontakteve të dyerve.

Shërbimi i transportit të gjyqtarëve dhe personelit për lëvizje administrative ka qenë një nga prioritetet e specialistëve të SSHM-së. Është bërë kontrolli teknik dhe riparimi i autoveturave në pronësi të GJKKO, dhe administrimi i sistemit të shpërndarjes së karburantit.

Në zbatim të urdhërave *“Për shpërndarjen e automjeteve dhe limitin mujor të karburantit që do të përdoret nga automjetet e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”* dhe *“Mbi ngritjen e komisioneve për hartimin e kërkesave për detajimin e fondeve buxhetore për vitin 2023”*, të Zëvendëskryetares së gjykatës, janë bërë në vazhdimësi planifikimet për shpenzimet operative dhe investime për nevojat e sektorit dhe mirëmbajtjen e godinës, hartimi dhe zbatimi i kërkesave për blerje materialesh për nevojat e sektorit, shërbimet e ndryshme, furnizimet me karburant për mjetet e transportit, kaldajën dhe gjeneratorin.

Gjatë gjithë periudhës vjetore është mbajtur nën kontroll dhe është riparuar sistemi elektrik, dyert, dritaret, ambienti rrethues si dhe zona e gjelbër e godinës.

## VIII. SEKTORI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT, STATISTIKAVE, MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN, MEDIAN DHE ME JASHTË.

Mbështetur në nenin 66 të Ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin nr. 6, datë 07.07.2023 të Këshillit të Gjykatës “Për miratimin e strukturës dhe organigramës së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, në GJKKO, sektori për Teknologjinë e Informacionit, Statistikave, Marrëdhënieve me Publikun dhe Median, është i përbërë nga një shef sektori, një specialist IT, një specialist për marrëdhëniet me publikun median dhe me jashtë.

Gjatë vitit 2023 u miratua struktura e re dhe u transferuan specialistët përkatës nga zyra e IT tek specialistët e IT, dhe ajo e zyrës për Marrëdhënien me Publikun në specialiste e Marrëdhënies me Publikun Median dhe me Jashtë. Gjithashtu gjatë vitit kalendarik u zhvillua edhe procesi për rekrutimin e shefit të sektorit, procedurë e cila përfundoi me emërimin e tij.

### A. Teknologjia e informacionit (IT)

Për sa i përket teknologjisë së informacionit, sektori, sikurse edhe në vitet e kaluara, vazhdon instalimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve teknologjike të renditura si më poshtë:

- Sistemi ARK IT, CCMIS/ICMIS, sistemi për menaxhimin e informacionit të gjykatës.
- Sistemi RDA (FTR audio), sistemi për regjistrimin audio/video të seancave gjyqësore.
- Sistemi i ndërlidhjes në distancë për zhvillimin e seancave gjyqësore me persona jo të pranishëm fizikisht në seancë gjyqësore.
- Sistemi i informimit dhe publikimit të të dhënave për publikun.
- Sistemi kompjuterik për çdo përdorues.
- Sistemi i printim/fotokopje.
- Sistemi “CCTV”, për regjistrimin e pamjeve filmike të sigurisë fizike.
- Sistemi i skanimit dhe detektimit të hyrjes së personave të tretë.
- Sistemi i dhomës teknike.
- Sistemi i detektimit/shuarjes së zjarrit në ndërtesë dhe mjedise të posaçme.
- Sistemi i qendëruar BMS i ndërtesës dhe mjediseve të posaçme.
- Sistemi i telefonisë.
- Sistemi i aksesimit të sigurt në mjediset e ndërtesës.
- Ndërlidhja me internet.
- Rrjeti kompjuterik.
- Sistemet Back-up.

Këto sisteme të instaluara dhe përditësuara ndër vite, nevojiten të monitorohen, përditësohen në vijimësi, (Update/Upgrade) duke ruajtur dublikate me qëllim mirëmbajtjen e punës në momente kyçe (backup).

Më poshtë ju rendisim një përshkrim të hollësishëm mbi secilin sistem, duke shfaqur gjendjen dhe ecurinë përgjatë vitit 2023.

### **1. Menaxhimi i çështjeve gjyqësore kryhet nëpërmjet sistemit ARKIT.**

Ky sistem u zhvillua dhe përditësua posaçërisht për gjykatën qysh në krijimin e saj, ish-Gjykata e Krimeve të Rënda. Me krijimin e GJKKO-së, sistemi u përshtat me nevojat e ndryshimeve të reja që pësoi legjislacioni në fushën e drejtësisë. Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2022 u instalua versioni i përditësuar i tij, me modelin bashkëkohor klient-server, me ndërfaqe “web” dhe bazën e të dhënave të përditësuar.

Në këtë sistem u realizua importimi i të dhënave të gjykatës së mëparshme “Gjykata e Krimeve të Rënda”, ashtu sikundër edhe çdo informacion tjetër i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2023, u riparuan shumë nga problematikat e evidentuara, duke listuar këtu edhe një sërë raportesh për efekt statistikash dhe ato të monitorimit. Ndërsa gjatë pjesës së dytë të vitit u integrua sistemi për hedhjen e shortit me autentifikim të çelësave publik/privat në serverat e KLGJ-së, duke realizuar kështu transparencë dhe gjurmim të procedurës.

Vlen të theksojmë faktin se sistemi i ri nuk realizon akoma gjenerimin automatik të statistikave standarde të KLGJ-së, si tabela 47 vjetore ose ato të raportit tremujor të gjykatës, apo edhe ato vjetore të ministrisë së drejtësisë, si pasojë nevojitet përpunimin manual i të dhënave duke rritur kohën e punës për përpunimin e tyre, çka mund të sjellë edhe gabime njerëzore në pasqyrimin e saktë të statistikave. Kjo problematikë duhet të marrë zgjidhje nga KLGJ-ja.

Sistemi i përditësuar është në kontratë mirëmbajtjeje nënshkruar nga KLGJ-ja dhe vijon të përditësohet apo zhvillohet sipas kërkesave të ndryshme e të nevojshme.

### **2. Sistemi RDA (FTR Audio)**

Ky sistem është mjaft i rëndësishëm për gjykatën pasi nëpërmjet tij realizohet regjistrimi audio për çdo seancë gjyqësore, duke siguruar transparencë në gjykim. Gjykata ka 5 (pesë) salla gjyqi, secila prej të cilave është e pajisur me këtë sistem. Gjatë vitit 2023 u ndërruan të pestë kompjuterat ekzistues me pesë të tjerë të rinj të cilët u prokuruan nga KLGJ-ja.

Sistemi është konfiguruar për të kryer regjistrimin në vendndodhjen work-station dhe të dhënat të kalojnë edhe në Server-in qendror të gjykatës. Ky konfigurim realizon jo vetëm mbrojtjen e të dhënave, por gjithashtu aksesimin paralelisht të tyre nga çdo njësi kompjuterike të ndërlidhur dhe me akses në mjediset e gjykatës, duke lehtësuar punën e sekretareve gjyqësore në plotësimin dhe zbardhjen e saktë të procesverbalit të seancës, po ashtu edhe gjyqtarëve në hartimin e vendimeve.

Gjithashtu nëpërmjet këtij sistemi realizohen kopje të seancave në CD/DVD për personat e tretë, si avokat apo palë, që kërkojnë të njihen me ecurinë e procesit. Ky sistem është i certifikuar nga institucioni i KLGJ-së, nënshkruar me kontratë mirëmbajtje të qendëruar nga kompania përkatëse.

Gjatë vitit 2023 me kërkesë të KLGJ-së u instaluan në mjediset e GJKKO-së kompjuterat e rinj me sistemin e përditësuar të RDA-së për pesë sallat e gjyqit. Gjithashtu u instaluan edhe 2 njësi kamera vëzhguese në secilën sallë për integrim me sistemin RDA, me qëllim regjistrimin e seancës gjyqësore si audio ashtu edhe video.

### **3. Sistemi i komunikimit në distancë.**

Në sallat e gjyqit të GJKKO-se janë instaluar 4 sisteme për komunikimin në distancë, të cilat në varësi të palës pritëse kanë protokolle kompjuterike të ndryshme duke realizuar video konferencë të enkriptuar jo vetëm për nevojat e gjykatës, por edhe për gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm, duke realizuar seanca marrjesh në pyetje dhe marrje dëshmish për të pandehurit që jetojnë në shtete të tjera të BE-së, në kuadër të bashkëpunimit juridiksional me autoritetet e huaja.

Pjesë përbërëse e sistemit është edhe kërkesa për të vëzhguar pamje filmike, audio, foto digjitale, të provave materiale gjatë seancave gjyqësore. Në përmbushje të kësaj kërkesë janë vënë në dispozicion monitor të madhësisë 50” në 4 (katër) salla gjyqësore.

### **4. Sistemi i informimit dhe publikimit të të dhënave për publikun.**

Sistemi i informimit dhe publikimit të të dhënave për publikun përbëhet nga faqja e internetit dhe kioska ndërvepruese (Touch-screen) me program të posaçëm për informimin e publikut, e cila gjendet në mjediset e publikut të GJKKO-së.

Nga raportet e hollësishme të mëposhtme, evidentohet se gjatë vitin 2023 ka pasur ~**1.400.000** aksesime të faqes së internetit, ku kërkesa më e lartë është tek menu-të “*Urdhër thirrje për gjykim*”, “*Njoftime “Kalendari i Çështjeve”*” dhe “*Njoftime për Shtyp*”. Kjo krahasuar me vitet e kaluara ka një rritje me gati tre herë, nga 500 mijë në 1.4 milion, me të njëjtën tendencë të kërkesave për informacion.

Gjatë vitit 2023 u rinovua dhe plotësua me dokumentacionin e nevojshëm menu-ja “Programi i Transparencës” sipas formatit të unifikuar për çdo institucion nga “*Komisioneri për të drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale*”.

Ndryshe nga viti 2022, në vitin 2023 u përditësua programi për kioskën elektronike (Touch-screen) duke rikthyer funksionimin e këtij sistemi. Përdorimi më i shumtë i kioskës është për menu-të “*Orari sipas datave*” dhe “*Lista e Shortit*”.

Problematikë e mbartur nga viti i mëparshëm është ajo e integritit të faqes së web-it me menutë e statistikave të menaxhimit të çështjeve gjyqësore. Si rrjedhojë orari i gjyqeve raportohet në mënyrë manuale vetëm për javën në vazhdim sikurse lista e shortit është konvertuar në raportim manual. Informacionet e tjera, të tipit “detaje të çështjes”, “çështje në gjykim”, “kohëzgjatja e


çështjes”, “informacion mbi seancën”, janë totalisht jashtë pune. Është detyrë e KLGJ-së (firmës së kontraktuar për rinovimin dhe mirëmbajtjen e programit), që të ofrojë një zgjidhje integrimi “API” në faqen e web-it për problematikën e sipërcituar.

Më poshtë janë tabelat përmbledhëse të detajuara bashkë me grafikët për aksesin e faqes së WEB-it.


**Tabela: Akses i faqes së internetit**

Menu	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Total
<a href="http://www.gjp.gov.al">www.gjp.gov.al</a>	64063	71170	65321	80943	294719	67747	338270	65070	163705	71752	79855	71260	1433875
<b>Kendi Informativ</b>	<b>1871</b>	<b>2469</b>	<b>2268</b>	<b>2921</b>	<b>9627</b>	<b>2429</b>	<b>10345</b>	<b>1529</b>	<b>6216</b>	<b>4004</b>	<b>3725</b>	<b>3409</b>	<b>50813</b>
Kalendari i çështjeve	305	290	388	403	1284	410	1407	201	781	575	454	430	6928
Çështje në gjykim	351	469	417	440	1607	463	1435	337	854	584	537	489	7983
Çështje të përfunduara	242	348	293	333	1539	336	1284	214	597	350	333	365	6234
Evidencat statistikore	104	118	117	124	423	102	1122	61	448	137	165	94	3015
Oraret e Gjyqeve	646	835	757	1296	3364	766	2660	435	1997	1511	1456	1336	17059
Lista e Shortit	223	409	296	325	1410	352	2437	281	1539	847	780	695	9594
<b>Gjykata e Posaçme</b>	<b>6729</b>	<b>8071</b>	<b>6364</b>	<b>7021</b>	<b>28662</b>	<b>6693</b>	<b>75561</b>	<b>7759</b>	<b>27195</b>	<b>8630</b>	<b>13816</b>	<b>9210</b>	<b>205711</b>
Organizimi dhe struktura	131	191	224	177	595	173	1181	137	518	307	238	253	4125
Orientimi në gjykatë	90	112	157	114	445	94	1098	61	484	144	167	148	3114
Njoftime	2519	2504	1465	1504	5777	1743	14497	1500	7434	2758	3706	2560	47967
Vendime të Këshillit të Gjyqes së Posaçme	569	586	601	690	2507	569	22744	805	11356	1079	1639	1306	44451
Urdhëra thirje për gjykim	3420	4678	3917	4536	19338	4114	36041	5256	7403	4342	8066	4943	106054
<b>Programi i Transparencës</b>	<b>1559</b>	<b>1644</b>	<b>1554</b>	<b>1653</b>	<b>5354</b>	<b>1158</b>	<b>40805</b>	<b>1413</b>	<b>10455</b>	<b>1361</b>	<b>2166</b>	<b>1427</b>	<b>70549</b>
Rregullore	281	399	399	348	1292	263	6196	309	2641	371	411	407	13317
Programi i transparencës	67	61	81	100	204	55	1076	51	418	79	129	109	2430
Koordinatori për të drejtën e informimit	68	67	80	78	187	53	1067	46	408	83	100	101	2338
Njoftime për shtyp gjyqtari i medias GJ.K.K.O	970	1017	907	1011	3436	693	31368	944	6585	754	1401	674	49760
Formulari Elektronik i Aplikimit	173	100	87	116	235	94	1098	63	403	74	125	136	2704


**Grafiku: Numri i aksesimit të faqes kryesore**




## Grafiku: Numri i aksesimit të Menu-ve kryesore




## Grafiku: Numri i aksesimit të nën-rubrikës “Këndi informativ”



**Grafiku: Numri i aksesimit të nën-rubrikës "Gjykata e Posaçme"**



**Grafiku: Numri i aksesimit të nën-rubrikës "Programi i Transparencës"**



## **5. Sistemi kompjuterik për çdo përdorues**

Në sistemin kompjuterik për vitin 2023, u rinovuan 4 kompjutera të prokuruar nga KLGJ-ja dhe 2 (dy) lap-top, të cilët u instaluan dhe konfiguruar me programet kompjuterike të përshtatshme për punën e përditshme, *Microsoft Windows 10, Paketa Office, Pdf, Sistemi i Gjykatës (ARK IT, i përditësuar), Sistemi FTR, driver printim-i, folder share për skanim dokumentesh, konfigurimi i kufjeve usb dhe kamera usb për trajnime në distancë.*

Gjithashtu gjatë vitit 2023 u përditësuan tre kompjutera për postet e sigurisë të gardës dhe të policisë, me qëllim monitorimin në kohe reale të sistemit të sigurisë CCTV për ambientet e brendshme dhe të jashtme të godinës së gjykatës dhe prokurorisë.

## **6. Sistemi i printim/fotokopjes**

Shërbimi i printimit përfshin pajisjet e printimit, fotokopjimit, skanimit dhe OCR. Ky shërbim është kontraktuar nga kompani e jashtme, e cila ofron çdo pajisje, bojë, shërbim fizik etj. Duke ofruar si shërbim fundor ~1 200 000 (një milion e dyqind) kopje gjatë gjithë vitit 2023, plus shtesë për 100 000 (njëqindmijë) si rezultat i kërkesës së shtuar për printim dhe fotokopjim të dosjeve dhe vendimeve gjyqësore voluminoze. Ky shërbim është realizuar nëpërmjet fotokopjeve profesionale dhe printerave. Të gjitha këto pajisje ndërlidhen në sistemin e rrjetit kompjuterik, duke ofruar mundësi që një përdorues të mund të printojë/skanojë informacionin e kërkuar për mbarëvajtjen e punës ditore.

## **7. Sistemi “camera station” për regjistrimin e pamjeve filmike të sigurisë fizike**

Sistemi i sigurisë së kamerave për regjistrimin e pamjeve filmike, përbëhet nga kamera me teknologji të lartë ip, të shpërndara në dy regjistruer NVR. Kjo mundëson zgjatjen e kohës së mbajtjes dhe regjistrimit të të dhënave, sipas vendndodhjes dhe kërkesës së historikut.

Gjatë vitit 2023 nuk ka pasur problematika të shfaqura nga ky sistem, vetëm kërkesa të ndryshme për ekstraktim informacioni nga institucionet përkatëse.

## **8. Sistemi i skanimit dhe detektimit të hyrjes së personave të tretë**

Ky sistem është instaluar si mjeti i parë i sigurisë fizike, për të mundësuar kontrollin fizik të çdo individit që hyn në mjediset e gjykatës. Gjithashtu kryen regjistrimin e fytyrës/bustit në mënyrë elektronike së bashku me temperaturën e personit hyrës.

## **9. Sistemi i dhomës teknike**

Dhoma teknike “server room” është rinovuar gjatë viteve të fundit duke instaluar dysheme teknologjike, kondicionim i alternuar për server room me ftohje të drejtpërdrejtë në rack, sistem BMS për detektim dhe lajmërim të parametrave të dhomës (*temperaturë, lagështirë, tym, voltazh të rrymës elektrike etj.*)

Në këtë sistem (BMS), gjatë vitit 2023 u realizua shtimi dhe integrimi i monitorimit të katër ambienteve të reja, përkatësisht tre dhoma arkivë dhe një e ruajtjes së provave materiale. Nëpërmjet këtij integrimi realizohet monitorimi dhe lajmërimi me e-mail për parametrat e



dhomave për detektim të kushteve jo normale, sikurse edhe ai i raportimit periodik të kushteve të ambienteve për ruajtjen e arkivës dhe provave materiale.

Sikurse gjatë viteve të kaluar 2021, 2022 edhe gjatë vitit 2023 janë përditësuar dhe sistemuar herë pas here terminimet e rrjetit kompjuterik, atij telefonik dhe ndërlihdjes së Switch-eve PoE për kamerat me sistemin e UPS-ve për të pasur vijimësi në ofrimin e shërbimit edhe në rast shkëputje të energjisë elektrike.

#### **10. Sistemi i mbrojtjes/shuarjes së zjarrit në ndërtesë dhe mjedise të posaçme**

Ndërtesa e gjykatës është e pajisur me sistem për mbrojtjen kundër zjarrit qysh nga krijimi i saj. Ky sistem është funksional dhe mirëmbahet nga stafi teknik i ndërtesës. Paralelisht me këtë sistem, funksionojnë edhe 5 (pesë) sisteme të tjera për mbrojtjen dhe shuarjen e zjarrit për mjedise të posaçme të cilat janë dhoma teknologjike “*server room*”, tre mjediset e arkivës së gjykatës dhe një dhomë për ruajtjen e provave materiale.

Këto sisteme kryejnë mbrojtje kundër tymit, nxehtësisë me sensorët përkatës dhe janë të integruara me sistemin e shuarjes së zjarrit, i përbërë nga gaz inert, i posaçëm për këto mjedise. Gjatë vitit 2023 u instalua sistemi i mësipërm në dhomën e tretë të Arkivës dhe në dhomën e ruajtjes së provave materiale, duke rritur kështu sigurinë fizike të materialeve të ruajtura në këtë hapësira.

#### **11. Sistemi i qendëruar bms i ndërtesës dhe i mjediseve të posaçme**

Sistemi BMS i ndërtesës është i integruar me sistemin ngrohje/ftohje, kaldajë, ndriçim etj. Ky sistem është amortizuar, instaluar në një sistem operativ *Windows XP*, dhe nevojitet të zëvendësohet. Meqenëse është sistem i integruar me mjaft komponentë të përmendur më sipër, është pothuajse e pamundur që sistemet e reja të integrohen me to. Ndaj vazhdon të mirëmbahet nga stafi teknik.

Ngelet për t’u nënvizuar se ky sistem ka nevojë imediate për përditësim apo zëvendësimin e tij.

Nga ana tjetër, të dhënat elektronike kanë përparësi të veçantë në “*server room*, rrjedhimisht është instaluar një sistem i veçuar BMS sikurse është përmendur tek paragrafi paraardhës, i cili ofron mjaft informacione të detajuara në monitorim dhe raportim në kohe reale.

#### **12. Sistemi i telefonisë**

Sistemi i telefonisë së gjykatës, është funksional dhe përbëhet nga një sistem i përzier i cili ofron si linja hyrëse *analoge, digjitale*, ashtu edhe hyrje nga *operator mobile*, por jo vetëm, pasi ofron edhe protokoll *interneti SIP*.

Gjatë vitit 2023 u prokuruan 30 telefona SIP, të cilët po zëvendësojnë telefonat analog të mëparshëm duke rritur kështu cilësinë e komunikimit të brendshëm të gjykatës.

#### **13. Sistemi i aksesimit të sigurtë në mjediset e ndërtesës**

Në mjediset e ndërtesës së Gjykatës së Posaçme si dhe në mjediset e përbashkëta me institucionet e tjera është i instaluar sistem i kartave të aksesit, ku çdo përdorues i pajisur me kartën e vetë identifikuese, në varësi të rolit të tij, mund të aksesojë hyrje/daljet e autorizuara.

Pjesë integrale e këtij sistemi është edhe leximi i targave të automjeteve dhe hapja në mënyrë automatike e traut hyrës/dalës në parkimin e bodrumit të institucionit.

Në kuadër të rritjes së sigurisë së godinës, gjatë vitit 2022 u shtuan pikat e kontrollit dhe aksesit, për përdorimin e ashensorëve, hapjen e traut të parking-ut dhe mbyllja automatike e hyrjes së publikut jashtë orarit zyrtar, duke mundësuar identifikimin e çdo përdoruesi si gjatë orarit të punës ashtu edhe jashtë saj.

Gjatë vitit 2023 është kryer shtimi i aksesit të dyfishtë si fizik ashtu edhe elektronik për tre dhomat e arkivave dhe një dhomë të ruajtjes së provave materiale dhe dhomës së stafit të arkivës. Kjo për arsye që aksesit në këto ambiente të jetë i identifikueshëm dhe i monitorueshëm për efekt raportimi.

Gjithashtu gjatë vitit 2023 u krye edhe upgrade i sistemit operativ nga Debian 7 në 11, për të realizuar integrimin me dhomat e reja, dhe përditësimin e sistemit operativ.

#### **14. Ndërlidhja me internet**

Sikurse gjatë vitit 2022, edhe për vitin 2023 ndërlidhja në internet është realizuar nga shërbimi i qendëruar i KLGJ-së, duke u futur në rrjetin e sigurt të të gjitha gjykatave, dhe aksesimin e sistemeve nga KLGJ-ja për efekt back-up etj.

### **B. Marrëdhëniet me Publikun, Median dhe me Jashtë**

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” nga Zyra e Koordinatorës është përgatitur Programi i Transparencës për GJKKO-në dhe është caktuar Koordinatori për të drejtës e informimit, i cili ushtron detyrat e përcaktuara në ligjin e sipërcituar. Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së autoritetit në kuadër të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” dhe vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Autoriteti Publik ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale, nën garancinë e ligjit 119/2014. GJKKO-ja përditëson herë pas here Programin e Transparencës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Gjykata ka zbatuar me sukses deri më tani planin dy vjeçar të komunikimit për gjykatat 2022-2024, nëpërmjet të cilave i është nënshtruar ndryshimeve funksionale, strukturore dhe organizative. Për dallim nga e kaluara, Plani i ri strategjik i Gjykatës u hartua për një periudhë 2-vjeçare (2022 – 2024), nëpërmjet të cilit Gjykata synon të vijojë traditën e përballimit të sfidave të së ardhmes, duke u bazuar në përvojën e fituar ndër vite dhe në mundësitë e reja teknologjike.

Me gjithë aktivitetet e ndërmarra gjatë vitit të kaluar, komunikimi me jashtë i Gjykatës ende përballet me sfida. Gjykata ka ndërmarrë hapa konkretë mbi rregullimin e rolit dhe përgjegjësi të brendshme, por edhe qasjes që Gjykata ka ndjekur me publikun dhe mediat. Komunikimi i përditshëm me mediat ndikon edhe shkrimet e tyre, ndaj edhe qasja për informim është i saktë dhe profesional. Vëmendje e veçantë i është kushtuar ecurisë së komunikimit me mediat, përmes një

qasje të strukturuar dhe aktive të komunikimit me ta dhe takime të përbashkëta ndërmjet Gjykatës dhe përfaqësuesve të mediave me gazetarë.

Sipas Planit të Komunikimit, për informimin më të mirë të publikut, një nga synimet kryesore ishte vendosja e një strategjie të mirëfilltë komunikimi.

Me vendimin Nr. 662, datë 02.11.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor z. Erjon Bani caktohet Gjyqtar për Mediat pranë Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Me kërkesë të Gjyqtarit për Media, për t i dëgjuar dhe duke vlerësuar rolin e medias në informimin e publikut mbi veprimtarinë gjyqësore, nevojën e kohës për dialog të vazhdueshëm me shtypin për vetë rëndësinë. Gjykata ka zhvilluar takime për të diskutuar me gjithë gazetarët që mbulojnë fushën e drejtësisë lidhur me të drejtën e informimit.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin Nr. 716, Datë 06.12.2023, miratoi “*Udhëzuesin standard të marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median*”. Përmes këtij Udhëzuesi Gjykata synon të sigurojë funksionim të pavarur dhe të paanshëm, transparent dhe llogaridhënës, efikas dhe efektiv. Përballja dhe funksionimi në hap me kohën, në kontekstin e zhvillimeve të reja teknologjike, imponojnë edhe përdorimin e teknologjisë informative dhe zhvillimin e kapaciteteve për përdorimin e saj. Gjykata, gjithashtu, ka ndërmarrë hapa për akses ndaj publikut, duke shtuar informimin, komunikimin, si dhe ka zgjeruar komunikimin me mediat në kohë reale.

Rubrika e programit të transparencës është përditësuar rregullisht në përputhje me detyrimet e përcaktuara në Ligjin nr. 119/2014 “*Për të Drejtën e Informimit*” dhe Ligjin nr. 196 115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”, i ndryshuar, si dhe synon vendosjen e marrëdhënieve pro aktive, transparente e informuese me publikun dhe median.

Gjykata ka intensifikuar punën e saj sidomos në rritjen e numrit dhe volumit të të dhënave të publikuara përmes faqes zyrtare dhe formave të tjera të shpërndarjes së tyre. Mirëmbajtja e faqes elektronike të Gjykatës dhe ofrimi i shumë njoftimeve sidomos në çështjet gjyqësore aktuale ka mundësuar përmirësimin e komunikimit me median. Krahas kësaj, kemi rekomanduar qasje më pro-aktive dhe zgjerim të përdorimit të metodave të komunikimit dhe forcimin e bashkëpunimit me mediat. Kjo pjesë mbetet e një rëndësie të veçantë për strategjinë e ardhshme të Gjykatës sonë.

Gjykata rregullisht ka komunikuar dhe bashkëpunuar me të gjithë palët e interesuara, organizatat vendase dhe ndërkombëtare që veprojnë në Shqipëri.

Komunikimi në kohë dhe transparent brenda Gjykatës është thelbësor dhe ka përmirësuar komunikimin e brendshëm në Gjykatë. Zyra për Marrëdhëniet me Publikun dhe Mediat vlerëson bashkëpunimin dhe koordinimin me gjyqtarin e Medias si edhe sekretaret gjyqësore në shkëmbim komunikimi me median/publikun.

Rëndësia e komunikimit për punën e Gjykatës është shumëdimensionale. Komunikimi me publikun kërkon qasje strategjike dhe jemi përqendruar në:

- Informim të vazhdueshëm të publikut, jo vetëm për procedurat e zhvilluara, por edhe aktivitetet e Gjykatës në tërësi.
- Përdorimin e të gjitha mjeteve të komunikimit në dispozicion, përfshirë teknologjitë e reja informative dhe mjetet tjera përkatëse.
- Përcaktimin e audiencës së synuar për secilin lloj të komunikimit (gazetarë, publik i gjerë, grupe të caktuara profesionale etj.).

Formati dhe përcaktimi i mesazhit që gjykata dëshiron të përcjellë tek publiku apo grupi i synuar.

Njoftimet mbi vendimet e Gjykatës, ndër të tjera: është përmirësuar më së miri formati standard i njoftimeve për media, me pikat kyçe të vendimeve të Gjykatës, sidomos në rastet e funksionarëve të lartë (çështje të rëndësishë së veçantë). Koordinatori tashmë punon ngushtësisht me Gjyqtarin e Medias, duke marrë udhëzime (përmbledhje të shkurtra të njoftimeve mbi shpalljen e vendimeve të gjykatës për të siguruar qarkullimin e informacionit) që duhet të vihet në dispozicion me transparencë të plotë nga sekretaret gjyqësore.

Zgjerimi i mundësive për përdorim të mjeteve të ndryshme të komunikimit ka mundësuar jo vetëm komunikimin e dyanshëm me publikun dhe palët e interesuara, por edhe marrjen e “feedback-ut” i dobishëm për t’u kuptuar sa më mirë mesazhet e Gjykatës dhe për të ndikuar në zhvillimin e mëtejshëm dhe përmirësimin e punës së gjykatës. Rubrika e kërkesave për informacion nga ana e Gjykatës është një mjet shtesë që e ofron këtë mundësi.

Koordinatorja nën mbikëqyrjen e Kancelarit ka përgatitur dhe dërguar në KLGJ Raportin 3 (tre) mujor mbi ecurinë e zbatimit të Planit të Komunikimit, proces i vazhdueshëm. Raporti tremujor bëhet gjatë muajit pasues të tremujorit të raportimit dhe duhet të përfundohet gjatë atij muaji. Raporti tremujor plotësohet në formën tabelore sipas aktiviteteve të planit të zbatimit. dhe ka për qëllim të raportojë dhe vlerësojë progresin e zbatimit.

**Tabela me statistikat e regjistrimit me kërkesa për informacion:**

Nr.	Data e regjistrimit të kërkesës	Objekti	Data e kthimit të përgjigjes	Përgjigje	Statusi i kërkesës	Tarifa
1	04.01.2023	Kërkesë për Informacion dhe vënie në dispozicion e dokumentacionit BIRN, Edmond Hoxhaj	14.01.2023	Në lidhje me kërkesën tuaj për marrjen e kopjeve të të gjitha vendimeve të marra nga GJKKO-ja duke filluar qysh prej datës 01.10.2021 e në vijim lidhur me kërkesat e SPAK për pushimin e procedimeve penale si në rastet kur këto kërkesa janë pranuar nga gjykata dhe në rastet kur nuk janë pranuar, si edhe të gjitha kopjet e vendimeve të marra nga GJKKO-ja në lidhje me ankimet e kryera kundër vendimeve, bashkëlidhur gjeni 3 (tre) vendime të anonimizuara. Vendimet kanë mjaft të dhëna sensitive dhe anonimizimi kërkon kohë. Një alternativë është: Mund të vini pranë zyrave tona dhe i shihni vendimet fizikisht, dmth i shfletoni një nga një këtu.	Përfunduar	Nuk ka
2	10.01.2023	Kërkesë për Informacion mbi statistikat, Tv Klan, Bleona Metushi	19.01.2023	Statistika/rekorde. Lista e plotë mbi proceset gjyqësore aktualisht pranë GJKKO-së. Lista e të pandehurve dhe atyre në mungesë	Përfunduar	Nuk ka
3	16.01.2023	Kërkesë për Informacion mbi Statistikat, Mimoza Picari VOA	19.01.2023	Vendime të marra nga Gjykata e posaçme për funksionarët publike në lidhje me korrupsionin dhe shpërdorimin e detyrës	Përfunduar	Nuk ka
4	17.01.2023	Kërkesë për Informacion dhe vënie në dispozicion të kopjeve të vendimeve, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Erida Skendaj	27.01.2023	Statistika/Lista e çështjeve të regjistruara/trajtuar dhe vendime të gjyko-se mbi korrupsionin e zyrtareve të lartë	Përfunduar	Nuk ka
5	17.01.2023	Kërkesë për Informacion mbi Statistika, Top Neës, Eduart Halili	27.01.2023	Statistika dhe të dhëna mbi çështjet penale të regjistruara nga 2021 prane Gjykates së Posacme te Shkalles se Pare per Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	Përfunduar	Nuk ka
6	23.01.2023	Kërkesë për Informacion, Lindita Çela, Gazetare e OCCRP, ( Organized Crime and Corruption Reporting Project)	31.01.2023	Kopje të vendimit VENDIMI 69, datë 18.05.2016 të dosjes gjyqësore me NR. AKTI 34	Përfunduar	Nuk ka
7	14.02.2023	Kërkesë për informacion. Programi Inside Story Top Channel		Statistika dhe të dhëna mbi çështjet e korrupsionit të zyrtareve dhe funksionareve të lartë		
8	21.02.2023	Kërkesë për Informacion dhe vënie në dispozicion e dokumentacionit BIRN, Edmond Hoxhaj	24.02.2023	Kopje të vendimeve të marra lidhur me kërkesat e SPAK për pushimin e hetimeve apo ankime kundër vendimeve të SPAK për mosfillim të procedimeve penale.	Përfunduar	Nuk ka
9	29/03/2023	Kërkesë për dokumentacion të vendimeve dhe të dhënave statistikore për çështjet e korrupsionit dhe krimin të organizuar për vitin 2022, Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes	05.04.2023	Kopje të vendimeve të kërkuara/ të anonimizuara të vitit 2022	Përfunduar	Nuk ka

10	19/06/2023	Kërkesë nga BIRN Albania, gazetari Edmond Hoxhaj per kopje të rregullores së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar	23/06/2023	Kopje e Rregullores së brendshme te GJKKO-së	Përfunduar	Nuk ka
11	04/07/2023	Kërkesë për kopje vendimesh, Roden Hoxha gazetar, Albanian Center for Quality Journalism	12/07/2023	Kopje Vendimi i konfiskimit te pasurive A. llsufaj (i anonimizuar)	Përfunduar	Nuk ka
12	10/07/2023	Tritan Hamitaj, Avokat, Në cilësinë e avokatit mbrojtës, të gjitha aktet e dosjes gjyqësore për çështjen penale në ngarkim të pandehurit Lefter Koka.	16/07/2023	Akte te dosjes penale, dosja gjyqësore e L.KOKA	Përfunduar	Nuk ka
13	11/07/2023	Fjoralba Sinoruka, Studente, Kopje të vendimit të gjykatës Vendimi numër 79, datë 06.12.2021	14.07.2023	Kopje e Vendimit nr. 79; 06/12/2021, (i anonimizuar)	Përfunduar	Nuk Ka
14	18/07/2023	Dritan Naum, Student, Vendime të GjKKO-së për dënimin e funksionarëve që kanë mbajtur detyra në Policinë e Shtetit kryesisht.	24/07/2023	Të dhëna statistikore, 2 Vendime të Gjykatës. Arsyetimin e Gjykatës që argumenton se ku është gjetur fajtor dhe përse është fajtor i pandehuri (që ka mbajtur postin e lartë në Policinë e Shtetit). Emrat e funksionarëve të anonimizuar	Përfunduar	Nuk ka
15	18/07/2023	Vilma Sokoli, Student Master Shkencor ne Drejtësi, Të dhëna statistikore, në lidhje me emrat e persona, struktura kriminale, që janë gjykuar për këtë veprë penale	25/07/2023	Të dhëna statistikore, në lidhje me emrat e persona, struktura kriminale, që janë gjykuar për kete veper penale, të anonimizuara emrat e të pandehurve.	Përfunduar	Nuk ka
16	23/08/2023	Eugen Gjyzari, Avokat, Me cilësinë e mbrojtësit të shtetasit Dhionisios Alfred Beleri, kërkojmë informacion në lidhje me vendimin e arsyetuar të datës 21.08.2023 me gjyqtare Flojera Davidhi me objekt "zëvendësim i masës së sigurimit".	25/08/2023	Kopje e Vendimit te arsyetuar Nr.323, date 21.08.2023, (i anonimizuar)	Përfunduar	Nuk ka
17	12/10/2023	Maringlen Kume, Gazetar, Kërkesë për Informacion mbi statistikat/numrin e zyrtarëve/funsonarëve publik, drejtorë drejtorie, specialistë dhe nëpunës të tjerë të, administratës publike ndaj të cilëve ka një vendim me dënim dhe pafajësi? (Për vitin 2023)	16/10/2023	Statistika dhe Numri i të dënuarve nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për veprat penale të parashikuara nga neni 258 i Kodit Penal, neni 245/1/1 I Kodit Penal dhe neni 259/1 ne lidhje me nenin 25 te Kodit Penal nga data 01.01.2023 -10.08.2023, sipas vendimit përkatës	Përfunduar	Nuk ka

18	12/09/2023	Roden Hoxha, Gazetar, Lista e emrave të gjithë të punësuarve pranë Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si ata që janë të emëruar në pozicione këshilltarësh; kancelar/e: sekretar/e gjyqësorë; në pozicione të të gjithë kategorive që kërkojnë statusin e nëpunësit civil; si dhe në pozicione me kod pune - ku të përcaktohen data e punësimit, arsimimi dhe pozicioni i secilit.	19/09/2023	Lista e plote e administratës gjyqësore të GjKKO-se, Gjithsej janë 46 punonjës të administratës gjyqësore. Lista aktuale është e hartuar në mënyrë kronologjike sipas vjetërsisë në punë. Punonjësit kryejnë veprimtarinë e tyre sipas përshkrimeve të tyre të punës, në zbatim të parashikimeve ligjore të Ligjit 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në RSH”, parashikimeve të Kodit të Punës dhe akteve nënligjore në zbatim të tyre.	Përfunduar	Nuk ka
19		Elton Qyno, Gazetar, Kërkesë për Informacion Vendimi i Gjykatës për subjektin, Flamur Sinanaj, vendim penal për konfiskim pasurie ndaj shtetasit Flamur Sinanaj				
20	10/10/2023	Artan Rama, Gazetar, Kërkesë Vendimin ndaj të pandehurve, të përfshirë në çështjen për ndërtimin dhe operimin e inceneratorit të Elbasanit (Albtek Energy), kërkoj që të njihem me dosjen e plotë (të prokurorisë dhe të gjykatës, bashkë) pas gjykimit në themel.	16/10/2023	Kërkesa është depozituar dhe protokolluar. Dosja penale gjyqësore dhe hetimore ndodhet pranë gjyqtarit të çështjes, i cili nuk e ka përfunduar zbardhjen e vendimit të plotë të arsyetuar, duke respektuar afatin ligjor të parashikuar nga neni 382/2 të Kodit të procedurës Penale dhe rrjedhimisht jemi në pamundësi objektive për t’ju vënë në dispozicion dosjen e plotë që kërkon. Në momentin e dorëzimit të dosjes gjyqësore me vendimin e arsyetuar në sekretarinë gjyqësore, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, do të marrë masat e nevojshme për të përmbushur kërkesën tuaj.	Përfunduar	Nuk ka

21	11/07/2023	Nikolin Muçaj, Kerkese per Informacion, Mbi Përbërjen e trupës gjyqësore për seancën gjyqësore në ngarkim të të pandehurit S.C akuzuar për figurën e veprës penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal, si dhe në ngarkim të të pandehurve E.K dhe F.K akuzuar për figurën e veprës penale “Korrupsioni aktiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë” në bashkëpunim, parashikuar nga neni 319 dhe 25 i Kodit Penal.dhe dispozitivin e vendimit dhe dënimin e caktuar per te tre te denuarit	11/07/2023	Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: Dërgimin për gjykim të çështjes penale në ngarkim të të pandehurit S.C akuzuar për figurën e veprës penale “Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal, si dhe në ngarkim të të pandehurve E.K dhe F.K akuzuar për figurën e veprës penale “Korrupsioni aktiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të drejtësisë” në bashkëpunim, parashikuar nga neni 319 dhe 25 i Kodit Penal. 2. Gjykimi i kësaj çështje u zhvilluar me rregullat e gjykimit të shkurtuar. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjyqësor të përbërë nga gjyqtaret Atalanta Zeqiraj, Rudina Palloi dhe Flojera Davishi, bazuar në nenet 112, 379, 384 dhe 406 të K.Pr.Penale, si dhe në nenet 47, 48, 49, 59, 319 dhe 319/ç të Kodit Penal, me vendimin Nr. 72, datë 06.11.2023	Përfunduar	Nuk ka
22	16/11/2023	Elisa Cela, Kandidate për magjistrate, profili prokuror Kërkesë Vendime gjykatë apo çdo material teorik/doktrinar, që eventualisht mund të dispononi, lidhur me veprën penale, “Fshehja e të ardhurave”, parashikuar nga neni 180, i Kodit Penal.			Përfunduar	Nuk ka
23	02/12/2023	Thomas Dhimolea, Avokat, Kërkesë për informacion ne lidhje me vendime te GJKKO-se te viteve 2022	10.12.2023	Vendimi nr. 1, 2022; Vendimi nr.24, 2022; Vendimi nr. 34, 2022; Vendimi nr. 41, 2022	Përfunduar	Nuk ka
24	11.12.2023	Roden HOXHA, Gazetar INA media, Kopje te vendimeve te marra nga ish-Gjykata e Krimeve te Renda te Shkalles se Pare ose nga GJKKO për çështje penale ne lidhje me te pandehurin Oriq Shyti, Laert Shyti, Altin Lamaj, etj...	20.12.2023	Kopje te te gjitha vendimeve te kërkuara, perfshire edhe vendimet per caktimin e masave te sigurimit personal ndaj tyre.	Përfunduar	Nuk ka



## IX. ANALIZA E PUNËS SË SEKTORIT TË PROTOKOLL/ARKIVËS

Në lidhje me realizimin e objektivave gjatë vitit 2023, duke qenë se dhe kuadri ligjor tashmë është më i plotë janë ndërmarrë masat e duhura për :

1. Inventarizimin e dokumentacionit gjyqësor/administrativ,
2. Përpunimin tekniko-shkencor të dokumentacionit arkivor,
3. Transferimin e dosjeve gjyqësore pranë Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor,
4. Përmirësimin e kushteve të vendruajtjes në lidhje me kushtet teknike dhe teknologjike për ruajtjen dhe sigurinë fizike të dokumenteve në zyrat e Sekretari-Arkivit dhe sallave të Arkivit në funksion të mirë administrimit të dokumenteve gjyqësorë.

Objektivat e sektorit të Protokoll-Arkivit për vitin 2023 janë realizuar me cilësi shumë të mirë duke rritur performancën e veprimtarisë së këtij sektori, në shërbimet e dokumenteve arkivore me saktësi në një kohë të shpejtë dhe brenda afateve ligjore. Këto detyra janë kryer në përmbushje të misionit dhe qëllimeve sipas të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi për punën me dokumentet zyrtare në Republikën e Shqipërisë si: “Ligji për Arkivat”, “Kodi i Procedurës Penale”, ”Ligji 98/2016 për “Organizimin dhe Funkcionimin e Pushtetit Gjyqësor”, “Ligji për të drejtën e informimit”, ”Ligji për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror”, Ligji ”Për mbrojtjen e të dhënave personale”, Vendimi nr.426, datë 14.10.2022 i Këshillit të Lartë Gjyqësor për “Miratimin e listave tip me afatet e ruajtjes së dokumenteve gjyqësore që arkivohen në gjykata”, Rregullore nr.202 Prot., datë 15.05.2023 “Mbi metodikën e punës arkivore të fondkrijuesve të Sistemit të Drejtësisë”.

Në zbatim të detyrave dhe orientimeve të lëna nga Kryetari dhe Kancelari i gjykatës, nga ana e specialistit të sektorit të Protokoll-Arkivit janë përgatitur materiale apo shkresa informuese që i janë drejtuar të tretëve siç janë: Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor. Nga ana e specialistit të Arkivit është informuar dhe raportuar në kohë për problematikat ekzistuese dhe të mundshme në lidhje me kushtet e ruajtjes së fondit arkivor, përpunimit tekniko-shkencor të dokumentacionit arkivor gjyqësor/administrativ si dhe masat që duhet të merren për realizimin e detyrave sipas përcaktimeve ligjore për Arkivat.

Duke parë ngarkesën e punës në këtë sektor dhe në pamundësi që inventarizimi i të gjitha dosjeve të ish-Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda të bëhet i vetëm nga ana e specialistit të Arkivit, për shkak se janë një numër tepër i lartë i dokumentacionit arkivor të papërpunuar që nga viti 2004, për të realizuar detyrat sipas standardeve ligjore për inventarizimin e këtij fondi nga ana e kësaj gjykate është parë e arsyeshme që të merren në punë punonjës me kohë të pjesshme në ndihmë të specialistit të Arkivit.

Në përmbushje të detyrave funksionale të përcaktuara në Vendimin nr.148, datë 29.03.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, u morën masat e nevojshme për funksionimin dhe mbarëvajtjen e

shërbimit arkivor sipas Legjislacionit Arkivor, Vendimit nr.426, datë 14.10.2022 i Këshillit të Lartë Gjyqësor për “Miratimin e listave tip me afatet e ruajtjes së dokumenteve gjyqësore që arkivohen në gjykata **konkretisht**:

- Është hapur regjistri i hyrjes së dokumenteve në vend ruajtje i cili plotësohet në mënyrë manuale me shkrim të qartë, të lexueshëm, pasqyruar gjithashtu dhe në mënyrë elektronike
- Është hapur regjistri për dhënien dhe marrjen e dokumenteve gjyqësore nga vend ruajtja
- Është hapur regjistri i korrespondencës
- Është hapur libri i shpërndarjes model 4/1 për dorëzimin e dokumenteve nga sekretaria në sektorë dhe anasjelltas.
- Është përpiluar dhe miratuar Urdhri për njësimin e dokumentit administrativ në Republikën e Shqipërisë
- Është përpiluar dhe miratuar Urdhri për ngritjen e komisionit të ekspertizës
- Është hartuar dhe miratuar lista konkrete me afatet e ruajtjes së dokumenteve me afatet e ruajtjes
- Është përpiluar dhe miratuar pasqyra emërtuese e çeljes së dosjeve.
- Në bashkëpunim me Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të Gjykatës është hartuar kërkesa për blerjen e kutive dhe dosjeve për ruajtje të përhershme sipas marrëveshjes kuadër me afat 4-vjeçar (2024-2027).
- Në lidhje me shfrytëzimin e dosjeve gjyqësore janë shërbyer një numër i konsiderueshëm dokumentesh të njësuara në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore në përgjigje të kërkesave të adresuara në drejtim të gjykatës. Janë vendosur në dispozicion të gjyqtarëve dosjet gjyqësore për llogari të gjykimit, janë shërbyer sipas afateve procedurale kopjet e akteve gjyqësore për personat e interesuar, avokatët si dhe institucionet shtetërore dhe jo shtetërore të cilat janë të evidentuara në regjistrin e dhënies dhe marrjes së dokumenteve nga vend ruajtja përgjatë vitit 2023.

Këshilli i Lartë Gjyqësor në zbatim të kontratës nr.2552/15 me objekt: “Program digjitalizimi i arkivave të gjykatave” ka kërkuar vënien në dispozicion palës kontraktuese “PC STORE” të dokumentacionit arkivor gjyqësor (**kodekset, regjistrat, aktet e protokollit**) të inventarizuar për të realizuar procesin e skanimit. Ky proces u realizua me sukses për aq sa ishte e mundur me përjashtim të akteve të protokollit të cilat nuk ishin të përpunuara që nga viti 2004 e në vijim dhe për rrjedhojë nuk ishin të përcaktuara se cilat do të jenë dokumente me RHK dhe cilat do të jenë ato me afat ruajtje të përkohshëm. Sipas udhëzimit të KLGJ-së nga ana specialistit të Arkivit menjëherë u bë e mundur hapja e një regjistri të posaçëm ku janë evidentuar të gjitha hyrje-daljet e dokumentacionit arkivor që do të skanohej. Më pas filloj puna për skanimin e vëllimit të vendimeve penale për vitet 2004-2022, regjistrave të Arkivit si dhe të gjithë regjistrave themeltarë penal të kësaj gjykate.

Gjithashtu, bazuar në gjetjet e konstatuara me procesverbalin e inspektimit Nr.DPA-DQ-2023-2, datë 21.03.2023, të “Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave” si dhe Urdhrit nr.145, datë 28.04.2023 të Kryetarit të Gjykatës, filloi puna për marrjen e masave administrative lidhje me sigurimin e

ambienteve arkivorë duke vendosur dyer të blinduara me brava automatike, u plotësuan kushtet teknike dhe teknologjike me mbrojtës kundra zjarrit, matës kundra lagështirës, rafte metalike dhe kuti kartoni për mbajtjen e dosjeve në sallat dhe zyrat e sekretari-arkivit të kësaj gjykate. Është plotësuar qartë libri i shpërndarjes model 4/1 për dorëzimin e dokumenteve nga sekretarisë në sektorë dhe anasjelltas. Është ndjekur me përpikmëri zbatimi nga ana e administratës së institucionit i Urdhrit nr.09, datë 10.01.2023 për “Njësimin e dokumentit administrativ” të Kryetarit të Gjykatës.

“Komisioni ekspertizës” i kësaj gjykate hartoi listën konkrete me afatet e ruajtjes së dokumenteve të GJKKO-së”. Filloi puna në lidhje me përpunimin tekniko-shkencor të dosjeve gjyqësore me afat ruajtje të përhershëm dhe të përkohshëm sipas vendimit nr.426, datë 14.10.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor për “Miratimin e listave tip me afatet e ruajtjes së dokumenteve gjyqësore që arkivohen në gjykata”.

Përparësi kryesore e punës në këtë sektor ka qenë lirimi i hapësirave të ambienteve të Arkivit të GJKKO-së. Për këtë qëllim janë marrë masa të shtuara me punonjës mbështetës me kontratë të përkohshme në ndihmë të specialistit të Arkivit për të dhënë ndihmesë për përpunimin tekniko-shkencor dhe inventarizimin e dosjeve gjyqësore të fondit arkivor të ish-Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda i cili do të ruhet në mënyrë të përhershme dhe nuk do ti nënshtrohet procesit të asgjësimit.

Për sa i përket procedurës së dorëzimit të dosjeve gjyqësore në Arkivin Shtetëror të Sistemit Gjyqësor kemi pasur një bashkëpunim të frytshëm me këtë institucion për realizimin e transferimit të dosjeve. Me shkresën nr.2033 Prot., datë 21.07.2023 të Drejtorit të ASHSGJ-së është miratuar kërkesa e mëparshme me nr.847 Prot., datë 20.10.2022 e bërë nga ana e specialistit të Arkivit për tërheqjen e fondit arkivor të vitit 2004, fond i cili ishte transferuar pranë ASHSGJ në vitin 2018. Pasi u tërhoq ky fond arkivor pranë Gjykatës sonë nga ana e specialistit të Arkivit u realizua me saktësi procedura e ripërpunimit sipas ndryshimeve të bëra nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor në “Listën tip me afatet e ruajtjes së dokumenteve gjyqësore që arkivohen në gjykata” dhe rekomandimeve përkatëse të bëra nga e ASHSGJ-së.

Bazuar në Rregulloren nr.202 Prot., datë 15.05.2023 “Mbi metodikën e punës arkivore të fondkrijuesve të Sistemit të Drejtësisë”, u bë transferimi pranë ASHSGJ-së, i dosjeve gjyqësore që i përkasin vitit 2004. Nga ana e sektorit të Protokoll-Arkivit vijon puna për përpunimin tekniko-shkencor të dosjeve gjyqësore për vitet 2005-2006 e në vijim, sipas të gjitha kriterëve të përcaktuara në legjislacionin arkivor, të cilat do të jenë të gatshme për tu dorëzuar pas verifikimeve dhe konfirmimeve përkatëse nga ana e Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor.

Përgjegjësitë kryesore në lidhje me objektivat e veprimtarisë arkivore, kryerjen e detyrave teknike, planifikimin e orarit të punës, janë realizuar në përputhje të plotë me aktet ligjore dhe nënligjore sipas afateve procedurale të përcaktuara.

Bazuar edhe në Rekomandimet/Sugjerimet e ASHSGJ-së përparësi në lidhje më vijueshmërinë e punës sipas standardeve arkivore duhet të marrë përpunimi tekniko-shkencor sa më i saktë i dosjeve gjyqësore të GJKKO-së ashtu si dhe dosjeve gjyqësore që i përkasin fondit arkivor të Ish-Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda të cilat do të nënshtrohen procedurës së transferimit në Arkivin shtetëror përkatës.

Vëmendje të veçantë duhet të marrë përpunimi dhe transferimi i dosjeve gjyqësore të ish-Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me qëllim lirin e hapësirave të ambienteve të Arkivit. Gjatë vitit 2023 ka qenë evidente nevoja për trajnimin nga ana profesionale e specialistit të Arkivit nëpërmjet trajnimeve vazhduese të cilat zhvillohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, Shkolla e Magjistraturës si dhe nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave sfidë kjo e cila ngelet për tu përmbushur në vitin pasardhës.

## **X. OBJEKTIVA DHE REKOMANDIME**

### **➤ Objektiva**

Analiza vjetore e punës për vitin 2023 e GJKKO-së është një mënyrë efikase për të evidentuar veprimtarinë e kryer nga institucioni gjatë këtij viti, për të reflektuar progresin e kryer, mangësitë e konstatuara dhe mundësitë për të bërë përmirësime. Në këtë analizë gjen vend edhe përcaktimi i objektivave respektive për të ardhmen, me qëllim përmirësimin e cilësisë së punës së gjithë secilit në funksion të ofrimit të shërbimeve dhe dhënies së drejtësisë.

Objektivat e GJKKO-së konsistojnë në ndërmarrjen e të gjitha masave të nevojshme dhe imediate me qëllim rritjen e performancës së këtij institucioni. Nëpërmjet tyre synohet në rritjen e kapaciteteve dhe efijencës në punë të gjyqtarëve dhe administratës gjyqësore, duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në dhënien e drejtësisë, si dhe ngritjen e standardeve aktuale drejt atyre evropiane.

### **Gjatë vitit të ardhshëm, GJKKO ka si synim, të marrë masa efektive në disa drejtime:**

- Rritjen e cilësisë dhe profesionalizmit në funksion të dhënies së drejtësisë, si dhe shërbimeve gjyqësore në tërësi të ofruara pranë GJKKO-së;
- Rritjen e efektivitetit dhe efijencës së proceseve gjyqësore;
- Ofrimi i një shërbimi cilësor në të gjitha aspektet, me synim rritjen e besueshmërisë së publikut në procesin e dhënies së drejtësisë;
- Rritjen e aksesit të publikut dhe medias në gjykatë, nëpërmjet një procesi proaktiv;
- Ngritjen e kapaciteteve dhe rritjen e transparencës ndaj veprimtarisë së GJKKO-së, duke synuar njëkohësisht mbrojtjen e të dhënave personale të palëve në proces, në zbatim të legjislacionit përkatës;
- Forcimin e bashkëpunimit me aktorë të tjerë në fushën e drejtësisë shqiptare dhe asaj ndërkombëtare;
- Kryerjen e përmirësimeve të sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore;
- Shtimin e burimeve njerëzore të gjykatës, si dhe trajnimin e tyre fillestar dhe vazhdues, me qëllim rritjen e cilësisë dhe performancës së shërbimeve të ofruara.

### **Objektiva afatshkurtër dhe afatmesëm janë:**

- Plotësimi në një kohë sa më të shpejtë i vakancave të gjyqtarëve në organikën e gjykatës, me qëllim shpërndarjen e barabartë të ngarkesës së çështjeve gjyqësore, që kanë gjyqtarët aktualë;

- Shtimi në një kohë sa më të shpejtë i organikës së administratës gjyqësore të GJKKO-së me punonjës të rinj sipas propozimit të Këshillit të Gjykatës.
- Përpunimi i dosjeve gjyqësore për ruajtje të përhershme/përkohshme, proces i cili do të vijojë të realizohet në bashkëpunim me KLGJ-në dhe Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor;
- Zëvendësimi i procesit manual të anonimizimit të vendimeve gjyqësore, nëpërmjet metodave të tjera efikase me mjete teknologjike;
- Ngritja e platformës për komunikimet elektronike, në bashkëpunim me KLGJ dhe KE;
- Rritja e komunikimit me aktorët e tjerë në fushën e drejtësisë, si: Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin të Organizuar, KLGJ-në, Gjykatën Kushtetuese, Gjykatën e Lartë, gjykatat dhe prokuroritë e rretheve gjyqësore, Ministrinë e Drejtësisë, Komisioni i Pavarur i Kualifikimi dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit, Shkollën e Magjistraturës, Dhomën Kombëtare të Avokatisë, Policinë e Shtetit, Zyrat e Përmbartimit, Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, Zyrat Vendore të Shërbimit të Provës, Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, duke planifikuar dhe kryer takime periodike me ta, për të evidentuar, diskutuar dhe zgjidhur problematika të ndryshme;
- Rritja e aksesit të publikut dhe medias në gjykatë;
- Monitorimi i vazhdueshëm mbi zbatimin e marrëveshjes me Postën Shqiptare sh.a., për sa i përket cilësisë dhe shpejtësisë së kryerjes së shërbimit të dorëzimit të dokumentacionit gjyqësor;
- Kryerja e trajnimeve për administratën gjyqësore e sidomos për sekretarinë gjyqësore në drejtim të përmirësimit të aftësive kompjuterike, etikës së komunikimit me publikun dhe zbatimit të ndryshimeve të reja ligjore, etj.
- Monitorimi i zbatimit të rregullave të funksionimit të teknologjisë së informacionit në gjykatë.

➤ **Për arritjen e këtyre objektivave rekomandojmë:**

1. Rritja e bashkëpunimit të GJKKO-së me KLGJ-në për plotësimin sa më të shpejtë të pozicioneve vakante për gjyqtarë sipas organikës së GJKKO-së;
2. Bashkëpunimi i GJKKO-së me KLGJ-në, për gjetjen e zgjidhjeve efikase, për zëvendësimin e procesit manual të anonimizimit të vendimeve gjyqësore nëpërmjet mjeteve teknologjike, për të shmangur pasaktësi të mundshme që ndodhin gjatë procesit manual të anonimizimit;
3. Rritja e bashkëpunimit me donatorët dhe partnerët ndërkombëtarë, lidhur me çështje të trajnimit të administratës gjyqësore dhe çështje të tjera;

4. Angazhim i punonjësve të trajnuar dhe eksperteve të jashtëm për ato çështje ku vlerësohet e nevojshme;
5. Ngritje e grupeve të monitorimit për secilën nga objektivat dhe raportim mujor mbi ecurinë e tyre nga grupet e punës përpara Këshillit të Gjykatës;
6. Monitorim periodik nga Këshilli i Gjykatës në lidhje me objektivat e caktuara dhe ndjekjen e ecurisë të secilës prej objektivave;
7. Paraqitjen e raporteve periodike KLGJ-së, si dhe kërkesa kësaj të fundit në lidhje me problematikat që kërkojnë ndërhyrjen e KLGJ-së për zgjidhjen e situatave.

Në përfundim, duke përfituar nga rasti, shprehim falenderime për të gjithë gjyqtarët, administratën gjyqësore, si dhe gjithë stafin e gjykatës, të cilët me angazhimin e tyre kanë bërë të mundur përmbylljen e suksesshme të vitit 2023.

Falenderime të mëtejshme i takojnë edhe KLGJ-së për bashkëpunimin e vazhdueshëm dhe ndihmesën e dhënë prej saj në zgjidhjen e problematikave të hasura gjatë kësaj periudhe, duke bërë të mundur, rritjen e cilësisë dhe efikasitetit në punë të gjykatës sonë.

## **KËSHILLI I GJYKATËS**